

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

FAKULTETI JURIDIK
STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA E MASTERIT:

**“DHUNA NË FAMILJE, SHKAQET E PARAQITJES NË
FAMILJET SHQIPTARE NË RAJONIN E POLLOGUT,
PERIUDHA KOHORE 2013-2018”**

Kandidati/ja :

Edona Ramani

Mentori:

Prof.Dr. Ismail Zejneli

TETOVË, 2020

Falenderime

Së pari falenderimi i takon Zotit të Madhëruar ndaj të cilit përulem me krenari.

“Edukimi është gjëja më e mirë që një baba mund t’ i jep fëmijës së tij – Muhamedi a.s.”

“Krejt çka unë jam , ose shpresoj të bëhem, i detyrohem engjullit Nënë – Lincoln”

Falenderoj thellësisht dhe u jam mirënjohëse përjetësisht dy personave më të veçantë në jetën time të cilët ishin në çdo hap të jetës sime duke më ofruar mbështetje të pa kusht emocionale dhe financiare.

Falenderoj babain tim Efraim Ramani dhe nënën time Xhemile Ramani, të cilët besuan dhe më përkrahën në çdo sukses timin. Faleminderit për dashurinë e pafundshme, për realizimin e gjitha dëshirave të mia, dhe mbi të gjitha faleminderit që kurrë s’morra përgjigje JO nga ana juaj!

E bekuar që ju kam!

Falenderoj mentorit tim Prof.Dr.Ismail Zejneli, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë gjithë kësaj periudhe, i cili me eksperiencën e tij, me përkushtimin dhe këshillat e tij më ka udhëhequr dhe shoqëruar në realizimin dhe finalizimin e temës sime të masterit.

Faleminderit profesor!

Parathënie

Manifestimet e dhunës që kanë origjinën e tyre ose justifikimin e tyre në proceset ndërfamiljare shkatërruese, zbulohen gjithnjë e më shumë nga profesionistët, ndërsa zvogëlojnë pranimin e këtyre situatave nga viktimat në një shoqëri që priren të supozojnë si një prej vlerave thelbësore, tolerancën zero kunddrejt këtyre sjelljeve.

Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës në familje duhet, në radhë të parë, të orientohet drejt parandalimit të dhunës në këtë fushë, duke krijuar kompetenca komunikuese, marrëdhënie afektive dhe disiplinore që tejkalojnë lidhjet e zakonshme midis dhunës-autoritetit. Në këtë artikull, paraqiten pikat e përbashkëta dhe dallimet më domethënëse midis manifestimeve të ndryshme të dhunës në familje (ndaj fëmijëve, kundër çiftit dhe ndaj të moshuarve), duke përfunduar me avantazhet, veçanërisht në nivelin parandalues, të një qasje gjithëpërfshirëse.

Abstrakt

Shenjat e dhunës që rrjedhin nga proceset shkatërruese të familjes janë gjithnjë e më të zakonshme dhe raportohen në një shoqëri që po bëhet zero-tolerante ndaj këtij lloji të sjelljeve. Përveç që janë të pjesshme dhe reaktive, qasjet tradicionale të bazuara në vëmendjen e viktimës dhe sulmuesit harrojnë shumë çështje që këto ngjarje kanë të përbashkët. Për të prishur lidhjen tradicionale midis dhunës, “fronit” mashkullor dhe autoritetit, qasja gjithëpërfshirëse ndaj dhunës në familje duhet së pari të synojë parandalimin e dhunës përmes promovimit të aftësive të komunikimit, marrëdhënieve afektive dhe disiplinës.

Ky punim ka tendencë që të përshkruaj fenomenin e dhunës me theks të posaçëm në familje (dhuna familjare). Do të tentojmë që të detektojmë në përgjithësi dallime të rëndësishme midis dhunës dhe shenjave të ndryshme të dhunës në familje.

Qasja hulumtuese e punimit është gjithëpërfshirëse, dhe jep udhëzime se si me korniza ligjore të parandalohet dhuna në familje.

Një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi është të detektohet se sa respektohen të drejtat themelore të njeriut, të drejta të cilat janë të mbështetura në parimin themelor se të gjitha qeniet njerzore janë të barabarta përpara ligjit pa marrë parasysh gjininë, racen, kombësinë, moshën, besimin kombëtar etj.

Pjesa empirike e punimit është modeste aq sa lejojnë kushtet tona për hulumtim empirik, gjithësisht do të bëhet hulumtim në rajonin e Pollogut dhe i njëjti do të tentohet që të gjeneralizohet.

Fjalë kyçe: familja, dhuna, dhuna familjare.

Abstract

Signs of violence stemming from destructive family processes are increasingly common and reported in a society that is becoming zero-tolerant of this type of behavior. In addition to being partial and reactive, traditional approaches based on victim and attacker attention forget many of the issues these events have in common. To break the traditional link between violence, the male “throne” and authority, a comprehensive approach to domestic violence must first aim at preventing violence by promoting communication skills, affective relationships, and discipline.

This paper tends to describe the phenomenon of domestic violence with a particular emphasis (domestic violence). We will try to generally detect important differences between violence and different signs of domestic violence.

The research approach to the paper is comprehensive, and provides guidance on how to prevent domestic violence through legal frameworks.

One of the main goals of this paper is to determine the extent to which fundamental human rights are respected, rights that are based on the fundamental principle that all human beings are equal before the law regardless of gender, race, nationality, age, national faith etc.

The empirical part of the paper is as modest as our conditions allow for empirical research, research in the Polog region will all take place and it will tend to be generalized.

Keywords: family, violence, domestic violence.

PËRMBAJTJA

Falenderime	2
Parathënie.....	3
Abstrakt	4
Abstract	5
Hyrje	8
Qëllimi i punimit.....	11
Metodologjia e punimit	12
KAPITULLI I-rë	13
1 DEFINIMI I DHUNËS NË FAMILJE	13
1.1 Nocioni i familjes.....	13
1.1.1 Aspekte historike.....	14
1.1.2 Aspekti teorik mbi nocionin familje.....	14
1.1.3 Aspekti normativ mbi nocionin familje.....	15
1.1.4 Aspekti ligjor mbi nocionin familje.....	16
1.2 Dhuna në familje dhe historiku i saj.....	16
1.3 Definimi dhe llojet e dhunës në familje	17
1.4 Dhuna fizike	21
1.5 Dhuna psikike.....	22
1.6 Dhuna seksuale	23
KAPITULLI II-të.....	25
2 FAKTORËT QË NDIKOJNË NË DHUNËN NË FAMILJE	25
2.1 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj grave	25
2.2 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj fëmijëve	29
2.3 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj të moshuarve	31
2.4 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj burrave.....	33
KAPITULLI III-të.....	35
3 DHUNA NË FAMILJE NË RELIGJIONIN E POLLOGUT	35

3.1	Përceptimi popullsisë mbi dhunën në familje	35
3.1.1	Raportimi i dhunës në familje në rajonin e Pollogut	36
3.2	Përceptimi mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje.....	39
3.3	Profili i dhunuesëve.....	42
3.3.1	Përkatësia gjinore.....	43
3.3.2	Mosha	44
3.3.3	Përgaditja shkollore.....	45
3.4	Qëndrimet e popullsisë mbi raportin e dhunës në familje.....	47
KAPITULLI IV-të.....		49
4	PARANDALIMI DHE MASAT PËR MBROJTJE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE.....	49
4.1	Roli institucional preventues	49
4.2	Roli policisë në parandalimin e dhunës në familje	50
4.3	Roli entit për punë sociale në parandalimin e dhunës në familje	53
4.4	Legjislacioni dhe mbrojtja e dhunës në familje	54
4.4.1	Mbrojtja juridiko-penale nga dhuna në familje	54
4.4.2	Ligji për parandalimin e dhunës në familje.....	58
STATISTIKA		60
PËRFUNDIMI		64
LITERATURA		67
SHTOJCA.....		70

Hyrje

Me anë të këtij hulumtimi do të paraqesim çështjen e dhunës në familje, duke e bërë të ditur pikë për pikë se cila është familja, dhe dhuna dhe se pse familja vuan nga dhuna. Dhuna familjare është një temë shumë e gjerë, që duke e analizuar atë na bën të mendojmë se në çfarë shoqërie po jetojmë ne dhe cilat janë vlerat e shoqërisë sonë.

Dhuna, kohëve të fundit paraqitet si një fenomen mjaft shqetësues në mbarë botën. Por ky fenomen vazhdon të veprojë edhe mes shoqërisë sonë, sikur të ishte mënyra e vetme, përmes të cilës disa prej tyre (dhunuesit) bëjnë që zëri i tyre të dëgjohet, ndërsa shumica, e dëmtuar (viktimat), duhet të vazhdojnë ta durojë atë.

Çdokush duhet të jetë i vetëdijshëm për dhunën e cila mund të ushtrohet në shtëpi, në ambientet e punës apo në rrugë. Kunddrejt dhunës nuk duhet të heshtim, sepse në qoftë se nuk e raportojmë atë atëherë nuk do të mund ti japim fund asnjëherë kaq shumë dhune e cila ushtrohet në vendin tonë dhe në mbarë botën.

Ne duhet të dimë që ka shumë lloje të dhunës që nuk janë vetëm fizika e qartë, që janë më “të zakonshmet” dhe më të lehtë për t’u zbuluar, por jo e vetmja, ekziston edhe ajo psikologjike, e cila është shumë e vështirë për t’u zbuluar, sepse nuk lë gjurmë fizike por e dëmton shumë viktimën kryesisht në vetëvlerësimin e saj duke e kthyer atë në një person të trishtuar, me frikë dhe të izoluar nga shoqëria.

Theksohet se dhuna është presioni psikik ose abuzimi i forcës së ushtruar ndaj një personi me qëllim të arritjes së qëllimeve kundër vullnetit të viktimës.

Dinamika e dhunës në familje ose me fjalë të tjera, ajo që lëviz, nxit, motivon dhe ushqen dhunën në familje është mendimi i një mentaliteti të sëmurë dhe egoist. Njeriu që abuzon dhe godet me dhunë familjen e tij, përpiqet të kontrollojë atë që me mençuri dhe dashuri nuk ka qenë në gjendje ta bëjë.

Fatkeqësisht, dhuna në familje është një e keqe që nuk fshihet lehtë, dhe as nuk mbaron në familjen që praktikohet, por përparon pothuajse në një mënyrë të trashëgueshme, duke arritur në familjet e reja të formuara nga fëmijët, të cilët nga ana e tyre ishin viktimat të këtij abuzimi të njëjtë.

“Shoqëria në Maqedoni karakterizohet me një strukturë patriarkle që në mënyrë dominante përcakton raportet jo të barabarta të fuqisë dhe pushtetit mes burrit dhe gruas. Rendi tradicional gjinor i roleve të meshkujve dhe femrave, roli dominues i burrit, në njërin anë, dhe pozita inferiore e gruas, në anën tjetër, si dhe perceptimi shoqëror për legjitimitetin e pushtetit të burrit përcakton pozitën e gruas në familje dhe në jetën familjare. Pranimi historik i dhunës në familje në shoqërinë e Maqedonisë përcaktohet nga vlerat sociale, ekonomike, politike, morale dhe nga zakonet”.¹

Me ndryshimin e legjislacionit nacional në vitin 2004, Ligjit për familje dhe Kodit Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për herë të parë konsiderohej si krim dhuna në familje dhe kjo formë dhune e humb karakterin e saj si çështje private midis famljes.

“Qëllimi kryesor i Strategjisë për parandalim të dhunës në familje është parandalimi i të gjitha formave të dhunës në familje ndaj çdo viktime, por masat të cilat i parasheh kjo Strategji ofrojnë qasje specifike që merret me nevojat individuale të viktimave. Duke pasur parasysh që si viktimat më të përfaqësuara të dhunës në familje janë gratë, Strategjia ofron një kornizë për masa specifike gjinore që kryesisht përqëndrohen në parandalimin e dhunës dhe në mbrojtjen e nevojave specifike të grave, por njëkohësisht ofron edhe një sërë masash dhe aktiviteteve që mbulojnë edhe viktimat tjera.”²

Nëse dhuna në familje nuk merr fund, modeli, shembulli dhe pasojat do të sillen në shtëpitë, të cilat në të ardhmen fëmijët do të duhet ti formojnë. Dhe praktikisht si një model i vendosur nga kjo familje jofunksionale, i njëjti model martesë do të përsëritet pafund për gjeneratat e ardhshme. Sipas rritjes së fëmijëve, vajza që mësoi nga nëna e saj dorëzimin, pranimin, tolerancën dhe abuzimin, gjithashtu do të vazhdojë të marrë këtë rol kur ajo martohet. Dhe djali që mësoi nga babai i tij të abuzonte me gruan e tij, gjithashtu do të jetë abuziv ndaj gruas së tij kur të martohet. Është interesante që ndërprerja dhe përmirësimi i marrëdhënieve martesore fillon të shihet kur të paktën njëri prej bashkëshortëve vjen nga një familje funksionale, edhe nëse tjetri vjen nga një jofunksional. Burri që si fëmijë e pa babanë e tij që abuzonte me familjen e tij, pa vetëdije merrte të njëjtin model këmbënguljeje dhe kontrolli abuziv në shtëpinë e tij.

¹ Strategji nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje

² Po aty.

Sidoqoftë çështja e dhunës në familje është shumë komplekse sepse në të gjitha situatat duhet të merret parasysh faktori i temperamentit.

Sigurisht, ne do të japim disa përkufizime, dhe disa statistika për të asimiluar më mirë realitetin dhe seriozitetin e kësaj të keqe që prek shoqërinë tonë. Si dhe, përmes këtij punimi do të japim udhëzime me qëllim edukimin e grave viktime të dhunës në familje.

Kur shikojmë rastet e dhunës në familje, ne mund të shohim pabarazinë dërrmuese dhe një përqindje të lartë të grave viktime, dhe viktimave të fëmijëve.

Prandaj, të gjithë anëtarët e një familje vuajnë, pavarësisht nga mosha apo seksi, kur ka dhunë në familje gjithçka ndryshon dhe ëndrrat bëhen makth vetëm duke parë prindërit që luftojnë.

Padyshim që ne kemi mjaft dhunë në botë për të folur më shumë rreth saj. Është shumë e rëndësishme të identifikohet, akuzohet dhe dënohet kjo lloj dhune sepse sulmon thelbin, bazën dhe themelin e shoqërisë sonë, siç është infrastruktura e shtëpisë dhe familjes.

Dhe ajo që do të përshkruajmë më tej do të na ndihmojë të kuptojmë se çfarë është dhuna, cila është familja, llojet e dhunës që ekzistojnë në familje dhe arsyet pse një person mund të sulmojë familjen e tij ose të saj pavarësisht ndjenjave të tyre dhe traumat që mund të shkaktojnë në to.

Qëllimi i punimit

Qëllim i këtij punimi është paraqitja, hulumtimi dhe studimi i hollësishëm i dhunës në familje, fenomen që është mjaft i përhapur si dhe shumë shqetësues për çdo familje dhe shoqërinë në përgjithësi.

Një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi janë respektimi i të drejtave themelore të njeriut, të drejta të cilat janë të mbështetura në parimin themelor se të gjitha qeniet njerzore janë të barabarta përpara ligjit pa marrë parasysh gjininë, racen, kombësinë, moshën, besimin kombëtar etj.

Përmes këtij punimi do të mundohem të japë pasqyrim të qartë për përgjegjësinë e shtetit që ka për parandalimin e dhunës në familje, por si dhe për marrjen e masave aktive për mbrojtjen dhe parandalimin nga veprat penale që mund të kryhen mbrenda familjes. Të ritet vetëdija shoqërore dhe përkujdesja për mbrojtje kompetente të viktimave të dhunës në familje, nga sjelljet e kundërligjshme.

Gjithashtu objektiva e këtij punimi është njoftimi, dhe ofrimi i zgjidhjeve të mundëshme, për krijimin e familjeve të shëndosha dhe të mbrojtura.

Metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë. Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme.

Materialet dhe literatura e përdorur për punimin e këtij hulumtimi kanë për qëllim njoftimin dhe ofrimin e zgjidhjeve të mundëshme, për krijimin e familjeve të shëndosha, dhe të mbrojtura.

Metodat kryesore që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave janë:

Leximi i literaturës së përshkruar më poshtë. Duke aplikuar këtë metodë jamë munduar të grumbullojë të gjithë librat e nevojshëm për realizimin e punimit duke i analizuar në thellësi.

Anketa. Si mjet anketues do të përdor fletët e anketimit, respektivisht pyetësorët, të cilët do të përmbajnë një numër të pyetjeve, në të cilët të anketuarit, do të kenë mundësi të zgjedhin përgjigjen e tyre nga opsionet e dhëna.

Jane marrë të dhëna nga interneti. Këto të dhëna do të studiohen dhe të analizohen me hollësi duke u përdorur për kristalizimin e punimit.

Në punimin shkencor me titull: “Dhuna në familje, shkaqet e praqitjes në familjet shqiptare në rajonin e Pollogut, në periudhën kohore 2013-2018” për të ju qasur hulumtimit kam përdorur këto metoda:

1. Metodën dogmatike juridike, duke marrë parasysh se në studimet e thelluara të drejtësisë asnjë punim i mirëfillt shkencor nuk mund të bazohet pa metodën gjegjëse.
2. Metodën empirike apo historike dhe metodën statistikore që u referohen të dhënave të ndryshme të institucioneve relevante në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me materien e sipërpërmendur.

Për të siguruar të dhëna më të sakta për përpilimin e këtij hulumtimi shkencorë, kamë përgaditur anketë, e cila përmban 21 pyetje. Me anë të së cilës janë anketuar mbi 200 persona

KAPITULLI I-rë

1 DEFINIMI I DHUNËS NË FAMILJE

1.1 Nocioni i familjes

Përcaktimi i familjes mund të jetë një gjë e vështirë, pasi vetëm fjala "familje" është një fjalë e fuqishme që ngjall kuptime dhe emocione të shumëfishta të ndryshme.

“Familja është institucion qëndror në të drejtën familjare. Njeriu , si rregull, lind, jeton dhe vdes në familje. Familja është cellula më e lashtë e organizimit shoqërorë, është një bashkësi shoqërore që do të thotë se është një formë e organizimit të shoqërisë. Mirpo kjo formë e organizimit të shoqërisë dallon nga organizimet tjera, sepse këtë e përbëjnë personat që në mes veti kanë lidhje specifike. Këtë bashkësi e përbëjnë, personat e lidhur me martesë ose bashkësi jashtëmartesore, dhe personat e lidhur me gjini si: prindërit si dhe personat e tjerë në gjini të gjakut.”³

Njeriu familjen e tij nuk e zgjedh, po atë e fiton në momentin e lindjes, kështu që çdo familje ka veçoritë e veta dhe karakteristikat e saj. Brenda familjes çdo person është më i lirë, si dhe ngrohtësinë që mund ta ndjejm brenda familjes nuk mund të krahasohet me asgjë. Antarët e një familjeje janë të lidhur shumë më njëri tjetrin, jo vetëm në aspektet juridike por edhe në aspekt emocional, ekonomik si dhe aspekte të tjera.

Fjala familja është një fjalë e fuqishme. Janë ata njerëz që ju rrethojnë me kujdesin e tyre, shqetësimin dhe dashurinë që falin çdo ditë. Këta janë njerëzit që ju shohin, të cilët e kuptojnë atë që po kaloni dhe përmes gjithë kësaj, ata qëndrojnë pranë jush duke ju dashur për jetë. Çdo familje ndryshon nga njëra tjera në shumë aspekte, por ajo që nuk mund të ndryshojë, ajo që kanë të përbashkët secila familje është se, njerëzit që e quajnë atë familje e bëjnë të qartë rëndësinë e këtyre personave në jetën e tyre.

Po ashtu në literaturë theksohet se rrethi familjar, ambienti i familjes, përcakton orientimet e para, jep udhëzimet mbi sjelljet e lejuara dhe të palejuara, mbi noramt morale, mbi ndalesat e

³ Sc. Abdulla Aliu, Mr.Sc. Haxhi Gashi “E drejta familjare” – Prishtinë 2007, fq.41

ndryshme. Në familje dhe ambientin familjar fëmijët fitojnë bazat e mirësjelljes, njohuri të para për vete dhe për jetën.⁴

Familja në të cilën mbretërojnë harmonia, raportet e mira dhe të drejta mes antarëve, sidomos marrdhëniet e mira dhe të ngrohta mes prindërve dhe fëmijëve, janë garanci e fortë se më pak do të ketë sjellje devijante dhe kriminale te fëmijët dhe te të miturit dhe në të njëjtën kohë besueshmëri se më pak do të viktimizohen antarët e familjes.⁵

1.1.1 Aspekte historike

Gjatë dekadave, shkencëtarët socialë kanë luftuar në përpjekjet e tyre për të përcaktuar konceptin shumëdimensional të familjes. Nëpërmjet hulumtimit të saj, Jan Trost (1990) e konfirmoi këtë dilemë dërrmuese të përkufizimit, jo vetëm nga hulumtuesit e familjes, por edhe nga popullata e përgjithshme. Për disa në shembujt e saj, familja përbëhej nga vetëm anëtarët më të afërt të familjes, familja bërthamore, ndërsa për të tjerët familja përfshinte të afërm të tjerë, miq, madje edhe kafshë shtëpiake.⁶

1.1.2 Aspekti teorik mbi nocionin familje

Familja është një grup njerëzish të cilët kanë lidhje gjaku me njëri tjetrin apo lidhje bashkëshortore. Antarët e një familjeje jetojnë së bashku dhe kanë kulturë dhe eksperiencë të përbashkëta.

Duke u mbështetur mbi shkencën e së drejtës familjare lidhur me kuptimin e familjes mund të thuhet: “ Familja përbën një bashkim personash të cilët, për shkak martesës, gjinis ose birësimit, janë të lidhur më së mëtej me marrdhënie psikologjike, morale, ekonomike dhe juridike, jetojnë në një ekonomi të përbashkët familjare dhe mbajnë para shoqërisë përgjegjësi për njëri tjetrin”.⁷

Sipas Deklaratës Univerzale të të drejtave të njeriut, 1. Burrat dhe gratë në moshë madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi. 2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të

⁴ Ragip Halili “Kriminologjia” – Prishtinë 2002, fq.256

⁵ Ragip Halili “Viktimologjia” – Prishtinë 2011, fq.74

⁶ <https://www.encyclopedia.com/reference/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/family-definition>

⁷ Hamdi Podvorica “E drejta familjare” – Prishtinë 2005, fq.30

lirë të personave që do të martohen.³ Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti .⁸

1.1.3 Aspekti normativ mbi nocionin familje

Aspekti kushtetues i institucionit të familjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Ligjet pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut rrjedhin nga garantimi kushtetues i disa të drejtave dhe lirive të njeriut, ku ndër të tjera kjo kushtetutë në fuqi, e miratuar në Nëntor të vitit 1991, parasheh mbrojtje të veçantë për familjen, me dispozitat kushtetuese në vijim:

Republika i siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë familjes. Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësinë jashtëmartesore rregullohen me ligj.

Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët e kanë për detyrë që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pamundur.

Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdes prindëror.⁹

Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për të pasur fëmijë.

Republika, me qëllim të zhvillimit të harmonizuar ekonomik dhe social, udhëheq një politikë humane të popullimit.¹⁰

Republika veçanërisht i mbrohet amësinë, fëmijët dhe personat e mitur.

Personi më i ri se 15 vjeç nuk mund të punësohet.

Personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë gjatë punës.

Personat e mitur nuk guxojnë të punësohen në vendet e punës, të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre.¹¹

Dispozitat kushtetuese të përmendura më lart nuk japin një definim të qartë mbi nocionin familje, por ajo që mund të kuptojmë nga interesimi i shtetit, për përfshirjen e këtij institucioni në aktin më të lartë të saj, është rëndësia e saj për krijimin e një shteti me një shoqëri të shëndoshë.

⁸ Deklarata Universale e të drejtave të njeriut, 1948.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, Neni 40

¹⁰ Po aty, Neni 41

¹¹ Po aty. Neni 42

1.1.4 Aspekti ligjor mbi nocionin familje

Ligji për familjen i Republikës së Maqedonisë së Veriut, familjen e definon kështu: “Familja është bashkësi jetësore e prindërve dhe fëmijëve dhe familjarëve tjerë, nëse jetojnë në familje të përbashkët. Familja krijohet me lindjen dhe adoptim e fëmijëve”¹²

Republika siguron mbrojtje të veçantë të familjes, amësisë, fëmijëve, personave të mitur, fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdesin prindëror. Republika siguron mbrojtje nga dhuna familjare.¹³

Prindërit ndaj fëmijëve të tyre kanë të drejta dhe detyrime të barabarta (të drejta prindërore). Marrdhëniet e prindërve dhe fëmijëve janë të bazuara në të drejtat dhe detyrimet e prindërve që të kujdesen për ngritjen, ruajtjen, edukimin dhe shkollimin e fëmijëve të tyre dhe të zhvillojnë aftësi dhe shprehitë e tyre punuese. Të drejtën prindërore e ushtrojnë prindërit bashkarisht në përputhje me nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe interesat e bashkësisë shoqërore.¹⁴

1.2 Dhuna në familje dhe historiku i saj

Fenomeni i dhunës në familje është prezent në të gjitha kulturat. Dhuna në familje ka ndjekur njerzimin gjatë gjithë egzistencës së vet shekullore.

Dhuna në familje ka qenë e dukshme gjatë gjithë historisë. Në shoqërinë e hershme romake, gruaja konsiderohej pronë e burrit dhe prandaj i nënshtrohej kontrollit të tij. Sipas ligjit të hershëm romak, një burrë mund të dhunonte, të divorcohej ose të vriste gruan e tij për shkeljet e kryera nga ajo, të cilat ndikonin në nderin e tij ose kërcënoni të drejtat e tij pronësore.

Në kohet e lashta, dhuna në familje ka qenë e përhapur me arsyetimin që, në atë kohë njerëzit kanë qënë të turpshëm që të mund të divorcohen si dhe në disa vende edhe ka qenë e ndaluar, dhe dukë marrë parasysh këtë, midis çifteve të cilët nuk kan pasur marrëveshje dhe dashuri midis tyre ka filluar të shfaqet dhuna, dhe jo vetëm midis bashkëshortëve por edhe ndaj fëmijëve të tyre. Më këtë nënkuptojmë që jo çdo martesë është e suksesshme, dhe një martesë e pasuksesshme lidhet me një familje të pakënaqur

¹² “Ligji për familjen”, Neni 2

¹³ Po aty, Neni 4

¹⁴ Po aty, Neni 8

Në vendin tonë deri vonë, dhuna në familje është konsideruar si diçka private dhe askush nuk ka mundur të ndërhy dhe as të merrej me zgjidhjen e problemeve të viktimave të dhunës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut termi “dhuna në familje” filloi të depërtoj nga fundi i shekullit XX. Ndërsa me ndryshimin e Kodit penal në vitin 2004, dhuna në familje kategorizohej si krim për herë të parë, ku viktimave të dhunës në familje ju mundësua mbrojtje juridiko-penale. (1) Ai që me forcë ose me kanosje serioze do ta detyrojë tjetrin të kryejë ose të mos kryejë ose të durojë diçka, do të dënohet me dënim me para ose me burg deri një vit. (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 është bërë gjatë kryerjes së dhunës familjare ose nga urrejtja, kryerësi do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri në tri vjet.¹⁵

Sipas Kushtetutes së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Neni 11:

“Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm.

Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues.

Ndalohet puna me detyrim.”¹⁶

1.3 Definimi dhe llojet e dhunës në familje

Është e vështirë të ofrohet një përkufizim unik i dhunës pasi është kryesisht një term gjithpërfshirës që shpreh situata të shumta dhe shumë të ndryshme. Duket, para së gjithash, se është një fenomen kompleks, i cili mund të afrohet nga shumë këndvështrime të ndryshme.

J. Sanmartin (2000) beson se "duke marrë parasysh se agresiviteti është i lindur në qeniet njerëzore nuk nënkupton të pranosh që, për qeniet njerëzore, është e pashmangshme të sillesh në mënyrë agresive". Dmth, qenia njerëzore është agresive nga natyra, por paqësore ose e dhunshme është sipas kulturës në të cilën zhvillohet.

Me nocionin dhunë në familje nënkuptohet keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi sigurisë, lëndim trupor, dhuna gjinore apo dhunë tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit ose frigës, dukë përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave tjerë që jetojnë në një bashkësi martesore ose jashtmartesore ose ekonomi të përbashkët familjare, si dhe ndaj bashkëshortit të

¹⁵ Kodi penal i RM-së, Neni 134

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, Neni 11

tanishëm apo të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryersi e ndan ose e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën ose jo.¹⁷

Pra me termin dhunë në familje mund të nënkuptojmë çdo lloj dhune e cila nënshtrohet kunddrejt cilitdo antarë të familjes, duke pasur për qëllim shkaktimin e dhimbjeve, frigës apo pasiguris ndaj viktimave, pa marrë parasysh nëse kemi të bëjmë me bashkëshortët martesor apo jomartesor, me fëmijët apo prindërit.

Viktimë e dhunës në familje mund të jetë çdo antarë nga familja, pa marrë parasysh gjinin dhe moshën e tyre.

Autori Buchler, dhunën në familje e përkufizon si atakim të integritetit trupor dhe mendor ndaj një personi në kuadër të një raporti familjar, duke përdorur forcën apo dhunën fizike dhe psikike nga personi i cili është më i fuqishëm fizikisht. Sipas autorit tjetër Schneider, me dhunë familjare kemi të bëjmë kur një person ushtron ose tenton të ushtrojë dhunë fizike, dhunë psikike, dhunë seksuale brenda një marrdhënieje familjare apo martesore në vazhdimësi apo herë pas here.¹⁸

Dhuna në familje është model i sjelljes me të cilin abuzuesi mundohet të fitojë dhe të ruajë pushtetin si dhe kontrollin mbi viktimën. Më kalimin e kohës dhuna fillon të shpeshtohet dhe të përkeqsohet gjendja edhe më shumë.

Dhuna në familje ndikon në të drejtat e njeriut dhe jo vetëm të grave, por edhe të fëmijëve, adoleshentëve dhe të moshuarëve, është gjithashtu e nevojshme të merret parasysh rastet e fenomeneve të dhunshme brenda familjes, të ushtruara kundër personave me aftësi të kufizuara.

Në të shumtën e rasteve protagonist kryesorë ndaj manifestimit të dhunës janë bashkëshortet, ku burri abuzon me gruan, po nuk mund të anashkalohet fakti se në këtë mes vuajnë edhe fëmijët të cilët mund të pësojnë dhunën fizike por edhe atë psikike. Gratë gjithashtu kanë më shumë mundësi që të jetojnë me partnerin e tyre vetëm nga frika se ai do ti dhunojë.

¹⁷ Ligj për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Neni 3

¹⁸ Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2011, fq75

Të gjitha marrdhëniet abusive kanë karakteristika të ngjajshme, kryersi i dhunës apo abuzuesi në të gjitha rastet ka për qëllim ushtrimin e fuqisë dhe kontrollit ndaj personit tjetër, për arsye se dhuna është mjet me të cilit mund të shtohet friga tek partneri tjetër, si dhe për të marrë në dorë kontrollin e asaj marrdhënie familjare.

Dhuna në familje është çdo veprim që kërkon të kufizojë në mënyrë sistematike ushtrimin e lirë ose gëzimin e të drejtave të njeriut të një personi, të ushtruar nga personi tjetër me të cilin ai ka ose ka pasur një lidhje, martesë, bashkëjetesë ose farefisni.¹⁹

Dhuna në familje është veprë e rëndë penale po aq sa edhe veprat e rënda penale. Gjithashtu definohet si një sjellje e dënueshme specifike. Në qoftë se nuk ndalohet dhuna në familje, mund të vihet edhe deri te vrasja apo vetvrasja e viktimës.

Realizimi i dhunës në familje ndodh në tre faza, edhe atë:²⁰

- Krijohet tension, abuzuesi fillon të kërcënoj dhe të kritikoj viktimën
- Abuzuesi bëhet i dhunshëm fizikisht dhe emocionalisht abuziv
- Faza e fundit, ku abuzuesi kërkon falje për të gjitha sjelljen e tij, premton se nuk do të përsëritet dhe fillon të behet i dashur. Por edhe pse faljet e bëjnë të shpresoj viktimën se gjërat do të ndryshojnë për mirë, abuzimet fillojnë përsëri nga e para, dhe e gjithë kjo nuk do të përfundoj deri në momentin kur abuzuesi kërkon ndihmë profesionale apo deri kur viktima të largohet përfundimisht nga ai.

Si kriminalitet i dhunës në familje, në literaturën kriminologjike, zakonisht cilësohen disa forma të dhunës që manifestohen me dhunën në martesë siç mund të jenë:²¹

- dhuna në mes të bashkëshortëve (burrit dhe gruas)
- dhuna ndaj fëmijëve
- dhuna ndaj prindërve të moshuar
- dhuna në mes vllazërve dhe motrave.

¹⁹ <http://www.violenciadomestica.org.uy/violenciadomestica.php>

²⁰ <https://www.shelterforhelpinemergency.org/get-help/cycle-violence>

²¹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2002, fq.174

Dhuna në martes, e veçmas dhuna ndaj gruas, shprehet me anë të rahjeve fizike, torturimeve psikike dhe keqtrajtimeve seksuale. Këto forma të dhunës zakonisht, janë më tepër të shprehura në martesat e çrregullta. Këto sjellje të dhunës, sipas konstatimeve në literature, zakonisht vijnë si rezultat i konflikteve, mosdurimeve, mospërshtatjes në mes të bashkëshortëve, kundërlthënies dhe mospajtimeve të gjata, për shkak të konsumimit të alkoolit, drogës dhe jetës së shfrenuar seksuale etj.²²

Fenomenet e dhunshme janë të pranishme në të gjitha kontekstet e qenieve njerëzore dhe padyshim, ka marrëdhënie midis atyre manifestimeve të dhunës që ndodhin brenda dhe jashtë mjedisit familjar. Një klimë sociale tolerante ndaj dhunës është një nga faktorët makrosocial që mund të favorizojë shfaqjen e dhunës në familje, nga ana e saj dhuna në familje mund të prodhojë shfaqje të dhunshme brenda dhe jashtë familjes: si në rastin e dhunës së bashkëmoshatarëve në rastin e fëmijëve dhe adoleshentëve që jetojnë në një klimë të dhunshme familjare, sulme ndaj mësuesve, etj.

Marrëdhënia e abuzimit është një situatë në të cilën një person me më shumë pushtet abuzon një tjetër me më pak fuqi për të kontrolluar marrëdhënien.

Në çift ndodh jo vetëm dhuna ndaj grave, por edhe dhuna ndaj partnerit mashkull dhe mund të gjejmë edhe dhunë midis çifteve të të njëjtit seks. Kështu, dhuna ndaj grave në çift është një nga nëntipet e dhunës gjinore.

Çdo formë e dhunës gjendet brenda një shkalle të sjelljes, me më pak ose më shumë të ngjarë të jetë vdekjeprurëse. Duke vlerësuar nivelin e rrezikut, dhuna në familje mund të diagnostikohet dhe parashikohet.²³

Si dhunë në familje kemi këto lloje:²⁴

1.1 Dhunë fizike

1.2 Dhunë psikike

1.3 Dhunë seksuale

Këto forma të dhunës, zakonisht janë më tepër të shprehura në martesat e çrregullta. Këto sjellje të dhunës sipas konstatimeve në literature, zakonisht vijnë si rezultat i konflikteve, mosdurimeve,

²² Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq.181

²³ <http://www.forodeseguridad.com/artic/miscel/6089.htm>

²⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2002, fq.175

mospërshtatjes në mes të bashkëshortëve, kundërthënieve dhe mospajtimeve të gjata, për shkak të konsumit të alkoolit, drogës dhe jetës së shfrenuar seksuale.²⁵

1.4 Dhuna fizike

Me dhunë fizike nënkuptojmë çdo veprim me të cilin ushtrohet forcë fizike apo çdo veprim me të cilin mund të rrezikohet shëndeti i viktimës. Kjo lloj dhune është një ndër format më të përhapura në mbarë botën.

Dhuna fizike në familje mund të ushtrohet ndaj çdo antari të familjes, kjo lloj dhune fillon nga disa lëndime më të vogla fizike, si një shuplakë apo një shtyerje dhe pastaj fillon bëhet më keq duke arritur edhe deri në vdekjen e viktimës. Më se shpeshti kjo formë e dhunës ushtrohet ndaj bashkëshortes, duke qenë se femra është qenia më delikate dhe e dobët, atëher kunddrejt saj do të mund të ushtrohej dhuna fizike shumë më lehtë.

Ndërsa derisa gratë shpesh viktimizohen, burrat gjithashtu përjetojnë keqtrajtime, posaçërisht verbale dhe emocionale. Dhe në fund të fundit sjelljet abusive nuk janë të pranueshme as për gjinin femërore e as për atë mashkullore.

Gjithashtu dhuna fizike ushtrohet ndaj fëmijëve si dhe ndaj prindërve të moshuar.

Është një krim që prek mijëra njerëz pavarësisht moshës, statusit ekonomik, racës, statusit të imigracionit ose orientimit seksual. Viktimat fillojnë të ndjejnë frikë, ndjenja të varësisë dhe të pasigurisë. Dhe fëmijët e viktimave përballen me të njëjtat realitete.²⁶

Abuzimi fizik mund të përfshijë një nga këto veprime: përdorimin e forcës fizike në mënyrë të atillë që lëndon dikë ose e vë atë person në rrezik lëndimi, duke përfshirë: rrahje, goditje, gërvishtje, shuplaka, dehje, kërcënim, prerje, tërheqja e flokëve, goditje në kokë, hedhja e objekteve me dhunë ndaj viktimës, shkundje, shtyerje, mbytje, kafshime, djegie, shkelmime, ose sulme me armë. Forma të tjera të abuzimit fizik mund të përfshijnë izolim ose çdo përdorim tjetër të rrezikshëm apo të dëmshëm force ose shtrëngimi.²⁷

²⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2002, fq.175

²⁶ <http://www.ctcadv.org/en-espanol/que-es-la-violencia-domestica/>

²⁷ <http://njohligjin.al/familja/dhuna-ne-familje/>

1.5 Dhuna psikike

Dhuna psikike apo emocionale mund të jetë verbale ose joverbale, dhe veprimet ose sjelljet janë të padukshme dhe të pa prekshme në krahasim me dhunën fizike. Abuzimi fizik mund të duket shumë më keq, por dhuna psikike është shkatërim emocionalisht. Disa shembuj janë: ²⁸

- duke nënvlersuar personin përmes kritikave të vazhdueshme, duke e fyer
- duke e frikësuar apo kërcënuar personin që të pajtohen
- duke e ngacmuar vazhdimisht personin
- duke mos besuar në marrjen e vendimeve të personit
- duke përdorur substanca narkotike si arsye për të ofenduar
- kontroll i tepërt i personit
- duke fajsuar tjetrin për veprimet e tija
- izolimin e personit nga familjarët dhe miqtë
- xhelozie e tepërt
- duke mos ju lejuar të vendosni vetë ²⁹

Shumë forma të abuzimit emocional nuk mund ti quajmë si krime, por mund të themi se këto forma janë shenja se abuzimi mund të përkeqësohet. Si forma të cilat i quajmë krime janë:

- ngacmim kriminal – ku përfshihet ndjekja e një personi apo tentimi i vazhdueshëm për të kontaktuar me të, kur personi nuk do kontakt dhe frikësohet prej tij
- kërcënimet për të dëmtuar tjetrin

Dhuna psikologjike është në përputhje me dhunën fizike ose dhunën verbale. Me fjalë të tjera, shpesh besohet se është e rëndësishme vetëm të merret në konsideratë agresioni fizik dhe aspekti mendor lihet mënjanë, siç janë mendimet që ndodhin në atë kohë dhe që mund të zgjasin për një kohë të gjatë derisa të trajtohen sepse është e qartë se viktimat kërkojnë ndihmë ose udhëzim për të kapërcyer atë që u është përjetuar. Dëmi i bërë një personi që ka qenë viktimë e një sulmi seksual nuk është vetëm dëmi që rrjedh nga lëndimet fizike ndaj trupit të saj ose të tij, trauma psikologjike që ngjarja mund të provokojë është pjesë përbërëse e dhunës së kryer, e cila është një lloj psikologjik i dhunës. ³⁰

²⁸ <https://www.ejemplos.co/15-ejemplos-de-violencia-psicologica/>

²⁹ Po aty.

³⁰ <https://www.thoughtco.com/what-is-psychological-violence-2670714>

Dhuna psiqike jo vetëm që ndikon në shëndetin mendor të individëve dhe në rrjetet e tyre sociale, por edhe i privon ato nga mundësitë për zhvillimin e ardhshëm personal, social dhe ekonomik.³¹

1.6 Dhuna seksuale

Abuzimet seksuale mund të jenë akte seksuale, kërkesa apo fyerje.

Dhuna seksuale, e imponon sjelljen seksuale ndaj një personi nëpërmjet përdorimit të forcës, frikësimit, shtrëngimit, manipulimit, kërcënimit ose ndonjë mjeti tjetër.³²

Ky lloj i kriminalitetit paraqet një rrezikshmëri të veçantë ngase cenon liritë dhe dijetetin seksual, si të viktimës ashtu edhe të familjes së saj, e sidomos në rastet kur si viktimë paraqiten fëmijët dhe të miturit të cilët nuk janë në gjendje që të mbrohen vetë nga atakimet e tilla të dhunshme seksuale. Megjithë faktin se këto krime janë të rënda dhe me pasoja afatgjate për viktimën, shikuar nga aspekti i vëllimit dhe numrit të regjistruar dhe të evidentuar në statistikat zyrtare kriminale, ato nuk janë shumë të përhapura.³³

Kërkimet e delikteve seksuale dhe dhuna seksuale tregojnë se në pjesën më të madhe të rasteve, si viktima paraqiten femrat. Zakonisht këto janë femra me nivel të ulët të arsimit, me një gjendje të dobët material, me kushte të vështira të banimit, janë të pamartuara ose të ndara ose kanë problem me përdorimin e alkoolit, drogës ose problem tjera të natyrës shëndetsore.³⁴

Forca nuk është e vetmja mënyrë për të pasur marrëdhënie, është gjithashtu e qartë se mund të ndodhë edhe përmes manipulimit dhe frikësimit.

Me fjalë të tjera dhunën seksuale mund ta definojmë si, çdo atakim seksual i cili bëhet pa pëlqimin e partnerit tjetër, apo realizim i aktit seksual me dhunë apo kërcënimë të ndryshme. Pa marrë parasysh se për një kohë të gjatë je në një marrëdhënie, partnerit asnjëherë nuk i jepet e drejta që të abuzojë seksualisht me partneren e tij. Në qoftë se partnerja refuzon të kryejë marrëdhënie, dhe pos kësaj partneri insiston, atëherë mund të themi se kryhet dhunë seksuale.

³¹ <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1334>

³² <http://www.violenciadomestica.org.uy/violenciadomestica.php>

³³ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.189

³⁴ Po aty, fq.193

Mund të përmendim këto shembuj:

- duke ju prekur pa dëshirën tuaj
- duke bërë komente seksuale
- ju detyron që të keni marrëdhënie seksuale
- sulmon pjesë të trupit tuaj seksual
- duke përfituar nga ju derisa jeni të dehur
- duke ju fotografuar apo filmuar pa lejen tuaj
- kërcënim për ndraje në qoftë se refuzoni të keni marrëdhënie

Si kryers të dhunës seksuale, në bazë të shënimeve statistikore zyrtare të shumë shteteve, më së shpeshti paraqiten personat e gjinisë mashkullore. Kryers paraqiten persona me përgaditje të ulët shkollore. Këto krime seksuale me dhunë, zakonisht kryhen duke u kërcënuar me përdorim të armës ose forcës fizike, varësisht prej konstrukcionit fizik të kryerësit apo viktimës. Këto krime shikuar sipas sezonës më tepër ndodhin gjatë muajve të verës ndërsa shikuar sipas kohës ato ndodhin më shumë natën se sa ditën³⁵

Mund të përfundojmë se krimet seksuale e veçmas dhunimet seksuale të femrave të reja dhe të fëmijëve, shkaktojnë pasoja të rënda në jetën e tyre të më vonshme. Këto veprime kriminale shkaktojnë ndryshime negative në jetën shpirtërore të viktimës, sidomos në sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Këta persona shpeshherë pas traumave të pësuar nga dhuna seksuale edhe vetë jepen pas vepimeve dhe sjelljeve tjera delikvente, si p.sh. merren me prostitucion, me vjedhje dhe me veprime tjera kriminale. Nga ana tjetër këta persona përjetojnë tronditje dhe çrregullime të rënda psikike dhe shpirtërore nga të cilat vështirë arrijnë të lirohen gjatë tërë jetës. Rastet e krimeve dhe dhunës seksuale, sjellin deri te dukuritë e vetëvrasjeve, dukuritë e dhënies pas alkoolit, drogës etj.³⁶

³⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.191

³⁶ Po aty, fq.193

KAPITULLI II-të

2 FAKTORËT QË NDIKOJNË NË DHUNËN NË FAMILJE

2.1 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj grave

Dhuna ndaj grave tani kuptohet gjithnjë e më shumë si një abuzim serioz i të drejtave të njeriut dhe ngadalë po njihet si një formë e rëndë e diskriminimit të bazuar në gjini. Dhuna ndaj grave, veçanërisht dhuna fizike dhe seksuale janë një ndër çështjet e rëndësishme të shëndetit publik në mbarë vendet e botës, edhe në vendet më pak të zhvilluara. Kur flitet për këtë dhunë, zakonisht mendohet në dhunën deri tani më të shprehur të burrit ndaj gruas. Si dhunë e tillë konsiderohet shtrëngimi në veprime të caktuara kundër dëshirës së njërit bashkëshort, maltretimeve fizik apo psikik etj. Si dhunë gjithashtu konsiderohet edhe keqtrajtimi seksual i bashkëshortes apo anasjelltas. Dhuna në martesë e veçmas dhuna ndaj gruas, shprehet me anë të rrahjeve fizike, torturimeve psikike dhe keqtrajtimeve seksuale. Këto forma të dhunës zakonisht janë më tepër të shprehura në martesat e çrregullta. Këto sjellje të dhunës, sipas konstatimeve në literaturë, zakonisht vijnë si rezultat i konflikteve, mosdurimeve, mospërshtatjes në mes të bashkëshortëve, kundërrthënieve dhe mospajtimeve të gjata, për shkak të konsumimit të alkoolit, drogës dhe jetës së shfrenuar seksuale etj³⁷.

Kjo lloj dhune gjithashtu prek edhe fëmijët, dhe mund të ketë pasoja vdekjeprurëse si, vrasje apo vetëvrasje.

Dhuna ndaj grave, nënkupton çdo akt dhune të bazuar në përkatësi gjinore, i cili u shkakton ose ka mundësi t'u shkaktojë grave dëmtim fizik, psikologjik, seksual apo vuajtje. Ajo përfshin kërcënimet për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar nga liria që mund të ndodhë në jetën publike apo private. Ky përkufizim vlen, përveç të tjerave, edhe për dhunën që ndodh brenda familjes apo shtëpisë, përfshirë këtu agresionin fizik dhe mendor, abuzimin emocional dhe fizik, përdhunimin dhe abuzimin seksual incestin, përdhunimin nga bashkëshortët, parterët e rregullt

³⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.181

apo të herë pas hershëm, personat me të cilët gratë bashkëjetojnë, krimet e “nderit”, gjymtimet seksuale dhe genitale dhe praktika të tjera të dëmshme për gratë, si psh: martesat e detyruara³⁸.

Në literaturën kriminologjike dhe viktimologjike hasen përkufizime të ndryshme të dhunës ndaj gruas, Autori Buchler, dhunën në familje e përkufizon si atakim të integritetit trupor dhe mendor ndaj një personi në kuadër të një raporti familjar, duke përdorur forcën apo dhunën fizike dhe psikike nga personi i cili është më i fuqishëm fizikisht. Sipas autorit tjetër Schneider, me dhunë familjare kemi të bëjmë kur një person ushtron ose tenton të ushtrojë dhunë fizike, dhunë psikike, dhunë seksuale brenda një marrdhënieje familjare apo martesore në vazhdimsi apo herë pas here³⁹.

Gratë të cilat janë me një nivel më të ulët të arsimimit, të cilat janë viktima të dhunës në familje, apo kanë qenë dëshmitare të dhunës në familje e cila është nënshtruar ndaj nënave të tyre kur ata kan qenë fëmijë, kanë më shumë gjasa që, dhunën e cila ushtrohet ndaj grave ta kutpojnë si diçka normale, dhe se burrat janë ata të cilët kanë privilegje dhe gratë duhet t’ju nënshtrohen burrave.

Po kështu si dhunë konsiderohet shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cënimit të dinjitetit, sulmit fizik, pa marrë parasysh pasojat, ofendimet, sharjet, thirrja me emra dhe nofka ofenduese dhe shqetësimet e tjera të vrazhda, përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit, marrdhëniet seksuale pa pëlqimin e tjetrit dhe keqtrajtimi seksual, kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër, dëmtimi apo shkatërrim i pasurisë dhe veprimet e tjera që kërcënojnë këtë, vënia e personit tjetër në pozitë që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale, ekonomike, hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët e personit tjetër dhe rëmbimi me dhunë i personit tjetër apo i fëmijës së tij (neni 2al. 1 dhe 2 e ligjit mbi mbrojtjen nga dhuna në familje)⁴⁰.

Kombet e Bashkuara të Amerikës e përkufizojnë dhunën kundër grave si: "Çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton, ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose psikologjik të grave, duke përfshirë edhe kërcënime për akte të tilla, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, të ndodhura në publik ose në jetën private"⁴¹

³⁸ Asambleja Parlamentare e Këshillit Të Evropës
(https://www.coe.int/t/pace/campaign/stopviolence/Source/handbook_al.pdf)

³⁹ Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2011, fq.75

⁴⁰ Po aty, fq.75

⁴¹ <https://www.who.int/es/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-women>

Femra më shumë se meshkujt i është ekspozuar rrezikut të viktimizimit në jetë. Shpjegimet lidhur me arsyet dhe faktorët që ndikojnë në viktimizimin e saj më të shpeshtë, janë të ndryshme. Këto shpjegime në pjesën më të madhe mbështeten në theksimin e vetive dhe ndikimeve të natyrës biologjike, psikologjike dhe sociale⁴².

Dhuna prek gratë e çdo moshe, statusi social dhe shoqëror dhe të çdo feje. Mund të ndodh brenda çiftit, në punë apo në hapsira publike.

Format e dhunës të cilat i drejtohen grave, të cilat i cekëm pak më lartë, mund të shkaktojnë pasoja të gratë që të vuajnë nga depresioni si dhe nga problemet e pierjes(alkoolit). Ndërsa sa u përket lëndimeve fizike, te gratë mund të paraqitet dhimbja e kokës, dhimbje abdominale, kufizime të lëvizshmërisë dhe shëndet të dobët në përgjithësi.

Dhuna ndaj grave mbetet një pengesë për arritjen e barazisë, zhvillimit, paqes, si respektimin e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave.

Shumë studime mbi dhunën në familje dëshmojnë se femra si viktimë e dhunës paraqitet në të gjitha fazat e jetës së saj. Femra sipas disa konstatimeve, nis të viktimizohet që nga paralindja, si fetusi, kur e ëma i nënshtrohet rrahjes dhe abuzimit gjatë shtatëzënisë dhe menjëherë pas lindjes, si fëmijë, me veprime të dhunës fizike, dhunës psikike dhe abuzimit seksual. Femra viktimizohet si vajzë me martesë të hershme, me akte të ndryshme të dhunës: fizike, psikike, dhunë seksuale, abuzim seksual, incestit, detyrimit në prostitucion, inkuadrimit me dhunë në industrinë pornografike dhe trafikimin e saj për nevojat të prostitucionit. Femra si grua e pjekur, ajo u nënshtrohet lloj-lloj keqtrajtimit fizike, abuzimeve seksuale dhe dhunës fizike e psikike në martesë, por edhe jashtë saj etj.⁴³

Marrëdhëniet e dhunës i çojnë viktimat në depresion. Një grua e lënduar vazhdimisht, pa perspektivë, dhe e cila ka arritur në përfundim duke besuar se jeta e saj nuk ka alternativa, do të bjerë në një gjendje depresive që do ta paralizojë atë edhe më shumë për të ndërmarrë veprime, dhe do ta perceptojë aftësinë e saj për t'i shpëtuar marrëdhënies si të pavlefshme.

⁴² Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2011, fq.76

⁴³ Po aty, fq.78-79 (Sipas burimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë)

Nëse çështja e dhunës është një problem që është i pranishëm në të gjitha shoqëritë dhe që nga kohra të lashta, pse është ende e fshehur dhe me pak zhvillim? Pse qëndrojnë gratë?

- Frikë – frika është një ndër arsyt kryesore se pse gratë qëndrojnë me abuzuesit, nuk largohen dhe ti braktisin ata. Në qoftë se gratë apo ndonjë familjar tjetër do ti paraqistë dhunesit në polici, atëher gratë frikësohen nga hakmarrja që mund të marrin abuzuesit ndaj tyre. Apo në disa raste abuzuesit i kërcënojnë ato, se në qoftë se ato do të largohen, atëher ato do t'ua marrin fëmijët dhe kto nuk do të mund ti shohin më kurrë, apo edhe i kërcënojnë me vdekje.⁴⁴
- Varësi emocionale – përkundër abuzimeve, ajo ende ndjen dashuri për të, gratë mund të ndjehen konfuze dhe të hutuara, sepse mendojnë që edhe ai i do dhe se do të mund ta kalojnë atë fazë së bashku, çdo gjë të kthehet në normalitet si më përpara. Ajo ndjen së është e vetmja e cila mund ta ndihmojë atë.⁴⁵
- Varësi ekonomike – ajo mund të jetë ekonomikisht e varur nga abuzuesi i saj, dhe nuk ka rrugëdalje tjetër vetëm që të durojë torturat e tij. Në shumë raste, gratë nuk kanë shumë mundësi punësimi, sidomos për ato të cilat janë edhe pa arsim të lartë, dhe duke mos pasur mundësi që të punësohen nuk mund të largohen nga abuzuesi, sepse edhe marrja e ndihmës sociale në shtetin tonë është një shumë e turpshme!

Duhet theksuar se në bazë të të dhënave që egzistojnë sot në literaturën kriminologjike, shumë nga këto organizata kanë kontribuar që dhuna ndaj gruas në martesë, në familje dhe më gjërë, të vështrohet në mënyrë më serioze dhe nga aspekti bashkëkohor shkencor dhe të flaken disa koncepte dhe paragjykime tradicionale që fatkeqsisht edhe më tej egzistojnë në disa mjedise në shoqërinë tonë. Mirpo nga ana tjetër, në këto lëvizje feministe ka edhe qasje ekstreme dhe të njëanshme, të cilat nuk çojnë kah parandalimi i dhunës ndaj femrës në familje, në martesë ose dhunës ndaj femrës në përgjithësi në shoqëri.⁴⁶

Numri lidhur me dhunën kundër grave është shumë i madh. Sipas statistikave të fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, një e treta e grave të botës kanë vuajtur aktet e dhunës së paku një herë në jetën e tyre.

⁴⁴ <https://ifstudies.org/blog/eight-reasons-women-stay-in-abusive-relationships>

⁴⁵ https://www.joinonelove.org/learn/why_leaving_abuse_is_hard/

⁴⁶ Ragip Halili "Kriminologjia" – Prishtinë 2011, fq.184

2.2 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj fëmijëve

Dhuna ndaj fëmijëve është një ndër dukuritë më të përhapura në tërë botën, kjo lloj dhune shfaqet si në vendet e pa zhvilluara, ashtu edhe në ato të zhvilluara.

Çdo vit, miliona fëmijë në mbarë botën bëhen viktime të dhunës në familje. Në çdo vend, në çdo kulturë dhe në çdo shtresë shoqërore, djemtë dhe vajzat përballen me forma të ndryshme abuzimi, braktisjeje dhe shfrytëzimi.

Fëmijëria konsiderohet si një ndër periudhat me të rëndësishme me të cilën zhvillohen fëmijët si individë dhe qytetarë në të ardhmen e tyre.

Një kohë të gjatë është menduar se çështja e trajtimit, kujdesit e mbikëqyrjes së fëmijëve nga prindërit ose kujdestarët, është çështje e brendshme familjare, i takon të ashtuquajturës “sferë intime”, është e drejt e paprekshme e familjes, prindërve dhe kujdestarëve. Personat e tjerë nuk duhet të ndërhyjnë e as të përyihen në këtë drejtim. Mirpo për shkak të dukurisë shumë të përhapur të dhunës ndaj fëmijëve, në tërë botën bashkëkohore tani po bëhen përpjekje që kjo dukuri të mos ngelë në sferën e brendshme familjare por të bëhet çështje e përgjithshme publike, me qëllim të eliminimit të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre.⁴⁷

Fëmijët të cilët më së shpeshti i nënshtrohen dhunës dhe viktimizohen, janë ata që rrjedhin nga familje problematike. Këto zakonisht janë familje në të cilat shfaqen konflikte, kundërbërje dhe probleme ekonomike e sociale. Rëndom bëhet fjalë për raste të familjeve të shkapërdredhura, të ndara, familje me trauma dhe strese permanente, ku nuk ka kujdes dhe përgjegjësi për fëmijët. Në këto familje zakonisht egziston varshmëria nga alkooli, substancat narkotike, është e pranishme breddhja, lypësia, prostitucioni dhe sjellje të tjera devijante.⁴⁸

Keqtrajtimi i fëmijëve përcaktohet si abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve nën moshën 18 vjeçare dhe përfshin të gjitha llojet e abuzimit fizik apo psikologjik, abuzimit seksual, neglizhencës ose shfrytëzimi për tregti ose ndonjë formë tjetër që mund të shkaktojë dëmtim të shëndetit, zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës.

⁴⁷ Ragip Halili “Kriminologjia” – Prishtinë 2011, fq.184-185 (R.Halili: Kriminaliteti kundër martesës dhe familjes në Kosovë, Prishtinë.1987. fq.60-63)

⁴⁸ Ragip Halili “Viktimologjia” – Prishtinë 2011, fq.80

Faktorët të cilët ndikojnë më së shumti në paraqitjen e dhunës në familje ndaj fëmijëve, mund të cekim si p.sh.: faktorët ekonomik, familja, shkolla, faktorët social si dhe faktorët psikologjik.

Nga kërkimet e shumta kriminologjike dhe viktimologjike të dhunës ndaj fëmijëve, është vërtetuar se si viktimat më të shpeshta të dhunës në familje paraqiten: fëmijët e padëshiruar, fëmijët që rrjedhin nga incesti, fëmijët që rrjedhin nga dhunimi seksual, fëmijët që vijnë nga kontakti seksual i nënës me personin që ajo e urren, fëmijët që kanë lindur pa dëshirën e nënës në çfarëdo mënyre, fëmijët që lindin gjatë krizave, skamjeve dhe mjerimit material dhe social të familjes, fëmijët që lindin megjithë tentimin e abortit, fëmijët me të meta fizike e psikike, fëmijët të cilët prindërit i kanë në burg, fëmijët që kanë lindur pas divorcit-shkurorëzimit, fëmijët nga martesat e mëparme dhe fëmijët jashtëmartesorë.⁴⁹

Dhuna në familje ndaj fëmijëve mund të jetë e natyrës fizike dhe psikike.⁵⁰

Dhuna fizike, manifestohet në formë të keqtrajtimit më të lehtë, duke rrahur fëmijën herë pas here, në formë të keqtrajtimit të rëndë, duke i shkaktuar dhimbje dhe lëndime fizike dhe keqtrajtimi shumë i rëndë i cili ka karakteristikat e shkaktimit të mundimeve e vuajtjeve sadiste dhe lëndimeve të rënda fizike të fëmijës. Këto veprime zakonisht i kryejnë prindërit që rrjedhin nga shtresat më të ulta sociale, të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike material dhe kushte të vështira të banimit.⁵¹ Abuzimi fizik shpesh nuk ndodh vetëm si izolim i fëmijut dhe ushtrim të dhunës fizike kundrejt tij, por kjo ndodh si rezultat i një varg sjelljesh, duke përfshirë këtu kontrollin autoritar nga prindi, sjellje provokuese apo mungesë të ngrohtësisë prindërore për fëmijët.

Dhuna psikike, ndodh kur rrezikohet ose dëmtohet zhvillimi social, emocional dhe intelektual i fëmijës. Format më të shpeshta të dhunës psikike janë: mbyllja e fëmijëve në lokale e dhoma të errëta, lënia e fëmijës vetëm në banes, sharja, fyerja e fëmijës, lidhja për shtrati, ndarja e prindërve, grindja e prindërve, konfliktet në mes të prindërve, dhuna e babait ndaj nënës, alkoolizmi i njërit apo i të dy prindërve, ndalimi i shoqërimit me fëmijë të tjerë, sjellja

⁴⁹ Ragip Halili "Kriminologjia" – Prishtinë 2011, fq.187 (S.Konantinovic-Vilic dhe V.Nikolic-Ristanovic, vep. e cit. fq. 131-132).

⁵⁰ Ragip Halili "Kriminologjia" – Prishtinë 2011, fq.187

⁵¹ Po aty.

indeferente ndaj fëmijës, mungesa e hapur e dashurisë dhe aftësisë prindërore, shtyrja në prostitucion, marrdhëniet incestuzore, abuzimi seksual dhe shitja e tyre.⁵²

Po ashtu, si forma të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve janë rahjet, keqtrajtimet fizike, plagosjet dhe lëndimet e ndryshme trupore, mosushqimi i rregullt, detyrimi në punë të rënda dhe joadekuate, detyrimi që të lypin, detyrimi në prostitucion, abuzimi seksual, incesti, kufizimi i lëvizjes së lire, mbyllja në lokale të rrezikshme, lënia pas dore e veshmbathjes, moskujdesi për mbrojtje shëndetsore, dhe shërimi, moskujdesi për vijim të rregullt të procesit mësimor, ndarja me dhunë nga nëna-prindi, grabitja me dhunë nga njëri prind, braktisja e tij për kohë të caktuar ose më gjatë, lënia e tyre për kujdes njerëzve të pandërgjegjshëm etj.⁵³

Keqtrajtimi i fëmijëve është një shkak i vuajtjes për fëmijët dhe familjet dhe mund të ketë pasoja afatgjata. Abuzimi shkakton stres dhe shoqërohet me çrregullime të hershme të zhvillimit të trurit. Rastet ekstreme të stresit mund të ndryshojnë zhvillimin e sistemit nervor dhe imunitar.⁵⁴

2.3 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj të moshuarve

Dhuna e ushtruar nga pjestarët e familjes ndaj personave të moshuar është ushtruar që nga kohët e hershme. Edhe pse kjo formë e dhunës së pari është identifikuar në vendet e zhvilluara, ku dhe janë kryer studime të shumta, nuk mund të themi se dhuna ndaj pleqëve nuk ushtrohet edhe në vendet në zhvillim.

Me nocionin dhunë ndaj të moshuarve nënkuptojmë, dhunën e cila paraqitet ndaj të moshuarve si e qëllimshme, me anë të së cilës shkaktohet dëm fizik, psikik apo emocional, duke përfshirë kërcënimin, poshtërimin, sulmin seksual dhe fizik, cënimin e privatësisë, izolimin e personave etj.

Kategoria e të moshuarve dhe prindërve si viktimë është në rritje në të gjithë botën. Dukuria e viktimizimit të të moshuarve mund të vërehet edhe në shoqërinë tonë. Kohë më parë kujdesi ndaj të moshuarve dhe sidomos prindërve ishte shumë më i madh.⁵⁵

⁵² Ragip Halili “Kriminologjia” – Prishtinë 2011, fq.187. (M.Milosavljevic: Seksualno nasilje nad djecom, Sarajevë,2000, fq.112-116,130-135.)

⁵³ Ragip Halili “Viktimologjia” – Prishtinë 2011, fq.80-81

⁵⁴ <https://www.who.int/es/news-room/fact-sheets/detail/child-maltreatment>

Në vendet perëndimore si moshë të vjetër e definojnë fazën kur personi del në pension që fillon nga 60 në 65 vjeç. Ndërsa disa studime të tjera këtë fazë e konsiderojnë në periudhën kur njeriu për shkak të sëmundjeve dhe dobësimit fizik nuk mund të kujdeset mirë për veten e tij. Si manifestohet dhuna ndaj të moshuarve?

Kjo formë e dhunës manifestohet duke lënë pas dore këta persona, moskujdesin ndaj tyre, mosdhënien e ushqimit, malltretime, mosfurnizim me barna të nevojshme për ata apo mosofrim të ndihmës shëndetsore.

Si faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj të moshuarve mund të përmendim si, atomizimin dhe copëtimin e familjes bashkëkohore, problemet jetësore, skamja, varfëria, rënia e kohezionit dhe solidaritetit brendapërbrenda familjes, kanë ndikuar me të madhe që disa detyrime morale dhe ligjore lidhur me ushqimin, kujdesin dhe mbrojtjen e prindërve dhe të moshuarëve të lihen pas dore ose të neglizhohen deri në skajshmëri. Kjo po sjell një formë të veçantë të dhunës ndaj kësaj kategorie të antarëve të familjes dhe të shoqërisë.⁵⁶

Në përgjithsi pranohet se dhuna e ushtruar ndaj personave të moshuar mund të kryhet me veprim apo mosveprim dhe se e njëjta mund të jetë e qëllimshme dhe jo e qëllimshme.

Nga kërkimet kriminologjike dhe viktimologjike në tërë botën, del se veprimet viktimizuese ndaj këtyre viktimave janë shumë të vrazhda. Zakonisht prindërit dhe antarët e moshuar të familjes nuk ushqehen dhe nuk kurohen sa dhe si duhet. Ata ditë të tëra lihen pa ushqim, pa kujdes për nevoja më elementare, nuk u jepet terapia konform lëngimeve dhe sëmundjeve që kanë. Rastet nga praktika tregojnë për dukurinë e mbylljes për ditë të tëra, për rrahje dhe shkaktim të lëndimeve trupore, për lënie pas dore të veshjes dhe kujdesit më elementar të higjienës trupore të tyre. Sipas disa rezultateve të publikuara lidhur me viktimizimin e kësaj kategorie, në shumë vende gjendja e këtyre viktimave nuk është aspak më e mire edhe atëher kur këta janë të vendosur në strehimore apo azile të pleqve, qofshin ato publike, qofshin private, meqë janë shënuar raste, por edhe dukuri, të viktimizimit të tyre.⁵⁷

Duke marrë parasysh të gjitha format e dhunës të lartë përmendura, kuptojmë se të gjitha keto lloje të dhunës shkaktojnë dhimbje apo vuajtje si dhe një jetë të vështirë për këta persona.

⁵⁵ Dr.Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2011, fq.84

⁵⁶ Dr.Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2011, fq.84

⁵⁷ Po aty, fq.85 (R.Halili:vep e cit., f.188-189, M.Singer: vep. e cit., f.287-297.)

Zakonisht personat e moshuar nuk ushqehen dhe as kurohen siç duhet, ata me ditë të tëra mund të lihen të pa ushqyer, duke mos u kujdesur për nevojat elementare të tyre, apo duke mos j'u dhënë terapinë e duhur për sëmundjet e tyre.

Abuzimi i pleqve ka pasoja serioze për individët dhe shoqërinë, përfshirë lëndimet serioze fizike dhe pasojat afatgjata psikologjike, rritjen e rrezikut të vendosjes në shtëpi pleqsh, përdorimin e shërbimeve emergjente, hospitalizimin dhe vdekjen.⁵⁸

Në këtë drejtim vërehet edhe tendenca e përdorimit të mjeteve dhe metodave johumane të trajtimit të tyre, si p.sh: mbyllja një kohë të gjatë në dhoma dhe lokale, dhënia e mjeteve për vënie në gjumë dhe qetësim, lënia në mëshirë të personave të tretë, vendosja nëpër institucione me qëllim shmangieje obligimeve ndaj prindërve dhe forma të tjera.⁵⁹

2.4 Faktorët që ndikojnë në dhunën në familje ndaj burrave

Dhuna ndaj burrave egziston, kjo mund të vërehet qartë çdo ditë dhe pasojat e kësaj dhune i vuajmë të gjithë si gratë ashtu edhe burrat. Sigurisht, të gjitha format e dhunës janë të papranueshme, kanë pasoja serioze dhe duhet të adresohen. Por dhuna ndaj burrave ushtrohet nga vetë ata ndaj njëri tjetrit. Krimi i organizuar, vrasjet politike, përleshjet dhe vrasjet për çështje pronësore, hakmarrjet, kidnapimet dhe shantazhet, të gjitha janë forma të dhunës që ushtrohen nga burrat ndaj burrave. Ata e rrezikojnë dhe sulmojnë njëri tjetrin për 'parime burrërie', për pronë, para dhe interesa biznesore. Kjo formë e dhunës ndodh haptas e madje edhe mbrohet me krenari.⁶⁰

Megjithëse nuk mund të thuhet se të gjitha format e dhunës në familje kryhen nga gjinia mashkullore. Ndonjëherë është babai dhe nëna së bashku ata që kryejnë sulme ndaj fëmijëve të tyre. Rastet të cilat kanë të bëjnë me papunësinë dhe nivelin e stresit të prodhuar nga rritja e varfërisë, është një nga treguesit e disa rasteve të dhunës në familje.

Ndërsa për sa i përket dhunës ndaj burrave në familje, në të shumtën e rasteve kjo formë e dhunës ushtrohet nga pjestarët e familjes së gjinisë mashkullore, si psh: babai ndaj djalit të tij,

⁵⁸ https://www.who.int/ageing/projects/elder_abuse/en/

⁵⁹ Ragip Halili "Kriminologjia" – Prishtinë 2011, fq.188

⁶⁰ <https://sbunker.net/me-tager/89254/per-dhunen-ndaj-burrave/>

xhaxhai apo daja ndaj nipit. Nervozizmin dhe agresionin te meshkujt e kemi të përditshëm në shoqërinë tonë.

Dhuna ndaj burrave nga gratë e tyre, nuk është si një problematikë e përhapur në vendin tonë. Raste që mund të ndodhë dhunë ndaj burrave nga gratë janë shumë të ralla. Sigurisht që duhet të trajtohen ligjërisht edhe këto raste si të gjithë të tjerat ku kemi të bëjmë me dhunë në familje.

Format e paraqitjes së kriminalitetit të dhunës janë të llojllojshme. Në vazhdim do të trajtohen disa nga format më të shpeshta të krimeve të dhunës, që manifestohen në jetën e përditshme.⁶¹

Partnerja ndaj burrit mund të abuzoj si p.sh. ju nënvlerëson apo poshtëron përpara shokëve, familjarëve ose në media, ju akuzon për jobesnikëri, mundohet të ju kontrollojë se ku shkoni dhe me kë takoheni, mundohet të ju kontrollojë se si i shpenzoni paratë tuaj, ju kërcënon se do te ju braktisë, kërcënon se nuk do të mund ti shihni fëmijët në qoftë se e lajmëroni për abuzim.

Pa marë parasysh gjininë, për ti dhënë fund një marrdhënie është njëjt e vështirë si për gratë ashtu edhe për burrat. Sidomos kur kemi të bëjmë me marrdhënie të cilat janë të rrethuara nga miq, familjarë dhe ku ka abuzim ne to.

⁶¹ Ragip Halili “Kriminologjia” – Prishtinë 2011, fq.178

KAPITULLI III-të


3 DHUNA NË FAMILJE NË RELIGJIONIN E POLLOGUT

3.1 Përceptimi popullsisë mbi dhunën në familje

Për sa i përket rajonit të Pollogut, pjesa më e madhe e personave janë të vetëdijshëm për dhunën në familje, si p.sh janë në dijeni për këto forma të dhunës, si: izolimi nga të afërmit apo miqtë, mohimin për mbështetje ekonomike, kritika të vazhdueshme, kërcënime për dëmtime fizike, pabarazi gjinore, poshtërime, malltretime, moslejimi i punësimit të grave, vrasjet apo vetëvrasjet për shkak të xhelozisë së tepërt, varësi emocionale, shfrytëzimin e fëmijëve në mënyrë që ata të punojnë për prindërit (lypës), lënien pas dore të fëmijëve, abuzim seksual etj.

Duke u bazuar në anketën e realizuar, në muajit shtator-tetor në qytetin e Tetovës, kuptojmë se të gjithë të anketuarit janë të njohur me fenomenin e dhunës në familje, ndërsa te pyetja se prej nga i kanë informatat për egzistimin e dhunës në familje, ata janë përgjigjur:

Grafiku 1.



Siç mund të vërejmë nga paraqitja grafike e përgjigjeve të të anketuarëve, mund të shohim se, vetëm 10% e të anketurëve kanë qenë dëshmitar të një dhune në familje, 25% e tyre informatat

për egzistimin e dhunës në familje e kanë nga antarët më të moshuar të familjes, 50% e të anketurëve janë të informuar përmes mediave, si dhe 15% janë përgjigjur me tjetër.

Informimi popullsisë mbi dhunën në familje është i domosdoshëm. Ekzistojnë dy fusha themelore nga të cilat informacioni mund të ndihmojë në modifikimin dhe formimin pozitiv të qëndrimeve të shoqërisë ndaj njerëzve, si më të vjetra janë: media dhe shkolla.


Shpjegimi më i rehatshëm për kulturën tonë, e cila është ende në thelb e dhunshme, ndaj dhunës që ne vëzhgojmë dhe vuajmë është se njerëzit janë qenie të dhunshme nga natyra. Sipas këtij këndvështrimi, ne nuk mund të parandalonim dhunën me çfarëdo lloj mase, ose të kërkojmë përgjegjësi, ose të bënim shumë për të zvogëluar dhunën, dhe njerëzit e dhunshëm nuk do të shtyheshin të ndryshojnë, sepse ata do të ishin aq të lindur dhe të pashmangshëm.

3.1.1 Raportimi i dhunës në familje në rajonin e Pollogut

Dhuna në familje dënohet me ligj, dhe viktima, si dhe çdo qytetar, mund ta raportojnë atë. Veçanërisht pozitive dhe shumë e rëndësishme për shoqërinë tonë është fakti që disa organizata në Republikën e Maqedonisë së Veriut po luftojnë kundër dhunës në familje dhe ofrojnë mbështetje për viktimat. Gjëja më e rëndësishme është që viktimat të mos heshtin dhe të raportojnë, ajo ka një kontribut të madh në luftën kundër këtij fenomeni dhe të detajojë ngritjen e zërit kundër çdo lloj dhune në familje.

Duke u bazuar në anketën e realizuar, në muajt shtator-tetor në qytetin e Tetovës, në pyetjen se: A mendoni se njerëzit nuk e shprehin lirshëm dhunën që kanë brenda familjes së tyre? Të anketuarit janë përgjigjur:


Grafiku 2.



Siç mund të vërejmë nga paraqitja grafike e përgjigjeve të të anketuarëve, mund të shohim se shumica e të anketuarëve 70% e tyre pajtohen se njerëzit nuk e shprehin lirshëm dhunën që kanë brenda familjes së tyre, 5% e tyre nuk pajtohen me këtë, ndërsa 25% nga ata janë përgjigjur se nuk kanë njohuri.

Ndërsa në pyetjen se: A mendoni se duhet të raportohet dhuna në familje? Të anketuarit janë përgjigjur:

Grafiku 3.



Duke analizuar paraqitjen grafike të përgjigjeve të të anketuarëve, mund të shohim se, shumica e të anketuarëve 86% janë përgjigjur se po dhuna në familje duhet të raportohet, ndërsa 14% e të anketuarëve janë përgjigjur me jo, se dhuna në familje nuk duhet që të raportohet.

Në 15 vitet nga krijimi i Qendrës së Ndhmës Juridike falas për viktimat e dhunës në familje në kuadër të Forumit të grave në Tetovë, numri i personave që raportojnë këtë problem është çdo ditë në rritje. Qendra thekson se përmbush vizionin e organizatës për të rritur vetëbesimin dhe ndërgjegjësimin, të të gjitha grate në vend, për të mos heshtur dhunën e cila ushtrohet kunddrejt tyre. Dhjetë vjet më parë kishte më pak se dhjetë raste të adresuara, ndërsa vitet e fundit ka pasur shumë më shumë raste të raportuara si dhe kërkesa për ndihmë.⁶²

Përmes fushatave të cilat i realizon kjo Qendër, njerëzit kanë mundësi të informohen edhe për seriozitetin e implikimeve ligjore të cilat kanë të bëjnë me këtë lloj dhune. Qëllimi kryesor është që të dhunuarit të ndërgjegjësohen që ta raportojnë dhunën, dhe të ndërgjegjësohen se është problem shoqëror. E rëndësishme është që të dalë nga familja, dhe jo të konsiderohet si problem familjar, të qëndrojnë e fshehur dhe e pa raportuar.⁶³

Tek ne dhuna në familje konsiderohet si problem familjar, dhe se askush nuk duhet të nderhyjë midis familjes, mirpo dhuna në familje është krim.

Sipas statistikave nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në vitin 2018 numri i përgjithshëm i viktimave të regjistruara të dhunës në familje është 919, nga të cilët 665 janë gra, 140 burra dhe 104 fëmijë.⁶⁴

Sot duhet që të gjithë njerëzit të jenë të vetëdijshëm se, dhuna në familje nuk u nodh vetëm të tjerëve, ajo mund t'ju ndodhë edhe njerëzve tonë më të afërt, qofshin ata njerëz me të cilët punojmë, njerëz me të cilët jetojmë apo me ata të cilët shoqërohemi, dhe ne në këto rastë nuk duhet që të qëndrojmë memec, por të kërkojmë ndihmë.

Viktimat duhet ta raportojnë dhunën dhe të kërkojnë mbrojtje nga shteti.

Çdo grua, dhe çdo burrë duhet të ndjehen të sigurtë në shtëpin e tyre, dhe në mjedisin se ku jetojnë. Kjo është një e drejt themelore e secilit prej nesh, dhe këtë na siguron shteti.

⁶² <https://www.slobodnaevropa.mk/a/29257782.html>

⁶³ Po aty.

⁶⁴ <http://www.mod.gov.mk/?mainnews=sekerinska-stop-za-semejno-nasilstvo-11-02-2019&lang=sq>

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, egzistojnë aktualisht 4 qendra rajonale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, të cilat gjenden në: Shkup, Koçan, Sveti Nikoll dhe Manastir. Gjithashtu në Kumanovë, Shkup dhe Tetovë, mbrenda ambienteve të kujdesit shëndetsor janë hapur qendra për viktimat e dhunës seksuale.


3.2 Përceptimi mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje

“Në vitin 2018 në qendrat për punë sociale në Maqedoni janë regjistruar 1300 raste të dhunës në familje, në të cilat pjesa më e madhe e viktimave kanë qenë gra. Kjo shifër tregon se dhuna në familje, veçanërisht dhuna mbi gratë në Maqedoni, ka tendencë të rritjes”.⁶⁵

Kërkimet e shumta, që janë bërë në këtë drejtim, vërtetojnë se paraqitja e kriminalitetit dhe shprëndarja e tij në regjionet fshatare, dallon nga paraqitja dhe shprëndarja e tij në regjionet e qyteteve, qendrave të ndryshme industrial. Këto dallime kanë të bëjnë si për nga format e vëllimi i paraqitjes ashtu edhe për nga shkaqet dhe pasojat e sjelljeve të tilla kriminale.⁶⁶

Pothuajse të gjithë të anketuarit te pyetja se: A jeni të vetëdijshëm se jetoni në një zonë ku është e pranishme dhuna në familje? Janë përgjigjur:

Grafikoni 4.




⁶⁵ <https://portalb.mk/582010-magedoni-dhuna-ne-familje-mes-ligjeve-dhe-ndergjegjies/>

⁶⁶ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.128

Nga paraqitja grafike e përgjigjeve të të anketuarëve mund të shohim se 85% e tyre janë përgjigjur me po, që janë të vetëdijshëm se jetojnë në një zone ku është e pranishme dhuna në familje, ndërsa 15% prej tyre janë përgjigjur me jo.

Ndërsa në pyetjen: A mendoni se dhuna në familje është më shumë e përhapur në fshat apo në qytet? Të anketuarit janë përgjigjur:

Grafikoni 5.




Duke u bazuar në përgjigjet e të anketuarëve shohim se 60% janë përgjigjur se dhuna në familje është e përhapur në qytet, 30% janë përgjigjur se dhuna në familje është e përhapur më shumë në fshat, ndërsa vetëm 10% e të anketurëve janë përgjigjur se është e përhapur dhuna në familje në të dyja rastet.

Kriminaliteti mund të studiohet në raport me vendin e kryerjes së tij, ai është i përhapur sikurse në vendet rurale poashtu edhe në vendet urbane, mirëpo kriminaliteti është i përhapur më shumë në zonat urbane se sa në ato rurale. Kriminaliteti në zonat rurale ka specifikat e veta që dallojnë

nga ai i zonave urbane, si psh.: krimet kundër jetës dhe shëndetit janë më të përhapura në zonat rurale, ndërsa krimi financiar, krimi i organizuar janë më të përhapura në zonat urbane.⁶⁷

Gjithashtu të anketuarit në pyetjen: Nga cili antarë mendoni se shkaktohet më shumë dhuna në familje? Ata janë përgjigjur se, dhuna në vendin tone më së shpeshti shkaktohet nga:

Grafikoni 6.



Duke analizuar përgjigjet e të anketurëve në pyetjen se nga kush shkaktohet më së shumti dhuna në familje, shohim se shumica e të anketuarëve ku 75% e tyre, janë përgjigjur se burri është ai i cili ushtron dhunën në familje më së shumti. Kjo na bën të kuptojmë se edhe në vendin tone ashtu si dhe në shumicën e vendeve të botës, është gjinia mashkullore ajo që ushtron më shumë dhunë në bashkësin familjare, dhe kjo si pasojë e traditave në shtëpi ose ka dhe raste të shumta ku si pasojë është gjendja financiare.

Një ndër arsyet kryesore të dhunës së ushtruar brenda familjes vlen të ceket edhe fenomeni i papunësisë, gjë që shkakton stres dhe në të shumtën e rasteve ushtrim dhune në familje. Kërkesat e shumta në familje rezultojnë të përhapin stresin brenda saj duke u përhapur dhuna psikike dhe përfundon në dhunë fizike në të cilën janë të përfshira kryesisht gjinia femërore

⁶⁷ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë 2018, fq.114 (V.Hysni, Kriminologjia, Tiranë,2005, fq.123)

Mirëpo në disa raste mund të themi se njerëzit nuk janë saktësisht të informuar për domethënien e dhunës në familje, shpesh mendojnë se është thjesht dhunë fizike. Dukë mos pasur parasysh edhe dhunën psikike, ekonomike apo atë seksuale.

Prapë se prapë konsiderohet se arsyeja për numrin e zmadhuar të viktimave dhe rasteve të regjistruara të dhunës në familje nuk ka të bëjë vetëm me zbatimin e dobët të ligjeve, po edhe nga edukimet e shumta, viktimat kanë arritur të vetdijësohen dhe të paraqesin dhunën në familje. Ka filluar të ngritet vetëdija, e sidomos tek femrat që të mos heshtin ndaj dhunës në familje.

3.3 Profili i dhunuesëve

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngime ose heqje arbitrare të lirisë.⁶⁸

Personat delikuentë si dhe njerëzit e tjerë normal, dallohen në mes veti për nga shumë veti anatomiko-fizike, bio-psikike dhe psiko-sociale. Të gjitha vetitë dhe cilësitë e caktuara subjektive, e karakterizojnë një delikuent si personalitet dhe si individ të veçantë.⁶⁹ Njohja e tipeve të delikuentëve dhe kriminelëve, posaçërisht vetive dhe cilësive të tyre themelore subjektive, ka rëndësi të veçantë në luftimin dhe pengimin e kriminalitetit në një vend të caktuar. Pa njohjen e tipave të ndryshëm të delikuentëve apo personave të dënuar, nuk mund të zbatohet me sukses klasifikimi i tyre nëpër ente të caktuara ndëshkimore-përmirsuese dhe as të realizohet procesi i rehabilitimit dhe risocializimit të tyre.⁷⁰

Mund të dallojmë disa kategori të kryerësve të dhunës në familje edhe atë: *burrat që dhunojnë bashkëshortet e tyre*, veçanërisht meshkujt me arsim më të ulët, shumica e të cilëve janë me të ardhura ekonomike shumë të ulta apo të pa punë, të alkoolizuar, që janë të varur nga lojërat e fatit, apo dhe xhelozë, *prindërit që dhunojnë fëmijët e tyre*, *fëmijët të cilët dhunojnë prindërit e tyre të moshuar*, këtë formë të dhunës në të shumtën e rasteve e praktikojnë meshkujt ndaj

⁶⁸ Organizata e Kombeve të Bashkuara (<https://telegrafi.com/dhuna-ne-familje-profil-dhunuesit/>)

⁶⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq.381

⁷⁰ Po aty.

prindërve të moshuar, zakonisht egziston kur nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike, të cilët janë të varur nga alkooli etj. Duhet theksuar se autorët e krimit kanë profile shumë të ndryshme, ata mund të kryejnë dhunë të përsëritura dhe prandaj rreziku i rishfaqjes është shumë i ndryshueshëm nga njëri subjekt në tjetrin.⁷¹

Sipas policisë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka shumë më pak raste ku gratë ushtrojnë dhunë ndaj bashkëshortëve të tyre. E vetmja formë dhune e cila mund të ushtrohet ndaj burrave nga grate, mund të jetë ajo psikologjike.

3.3.1 Përkatësia gjinore

Për sa i përket gjinisë, duke u bazuar në analizimin e përgjigjeve të të anketuarve, na bën të kuptojmë se gratë janë në rrezik më të madh të viktimizimit nga dhuna në familje, siç mund të jetë dhuna fizike dhe psikologjike dhe se janë dy herë më të prirura që të jenë viktime të dhunës në familje nga vetë bashkëshortët e tyre.

Me fjalë të tjera, dhuna gjinore në këtë rast ndaj grave është një mënyrë për të sulmuar jetën e saj, fizikisht, psikologjikisht, seksualisht, ndër të tjera.

Të dhënat e kërkimeve viktimologjike tregojnë se te këto veprime kriminale, në pjesën më të madhe, paraqiten personat e gjinisë femërore. Mirëpo pjesëmarrja më e madhe apo më e vogël e gjinive në viktimizim varet edhe nga faktorët socioekonomikë, nga pozita e gjinive në shoqëri, nga pozita dhe roli i femrës në familje, nga ndikimi i normave tradicionale si dhe shumë faktorë të tjerë.⁷²

Gratë vetëm pse janë gra u nënshtrohen formave të ndryshme të dhunës nga ana e partnerëve të tyre, ose nga mjedisi i tyre, duke filluar nga kontrolli e deri tek sulmet fizike. Kjo është e justifikuar sepse në shumë kultura besohet ende se burrat kanë të drejtë të kontrollojnë gratë si dhe të ushtrojnë dhunë mbi to. Marrëdhëniet e dhunës i çojnë viktimat (gratë) në depresion. Një grua e lënduar vazhdimisht, mund të arrijë në përfundim duke besuar se jeta e saj nuk ka alternativa, do të bjerë në një gjendje depresive që do ta paralizojë atë edhe më shumë për të

⁷¹ <https://telegrafi.com/dhuna-ne-familje-profil-dhunuesit/>

⁷² Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë 2011, fq.51-52

ndërmarrë veprime, dhe do ta perceptojë aftësinë e saj për t'i shpëtuar marrëdhënies si të pavlefshme.

3.3.2 Mosha

“Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar kohë më pare. Këteleja e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendenca më e theksuar e krimit zhvillohet në proporcion me intenzitetin e forcës fizike dhe pasionin e personit.”⁷³

Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme.⁷⁴

Mosha konsiderohet si një ndër karakteristikat më të rëndësishme të fenomenit kriminal. Në vende të ndryshme, sipas ligjeve positive penale, mosha e kyerësve të veprave penale ndahet në mosha të personave të mitur dhe personave të rritur. Legjislacioni penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut, varësisht nga mosha, të miturit i ndan në disa grupe, edhe atë: persona të mitur të rinj konsiderohen prej 14-16 vjeç, dhe të mitur të rritur konsiderohen prej 16-18 vjeç. Kategoria e personave deri në moshën 14 vjeçare, në qoftë se kryejnë veprime delikuede, nuk ju nënshtrohen trajtimeve juridiko-penale. Por ndaj tyre mund të ndërmeren masa të kontrollit apo të mbikqyrjes nga ana e prindërve apo nga ana e organeve përkatëse.

Në vendin tonë për sa i përket dhunës në familje, nuk mund të themi se ka një moshë të caktuar se cilët e kryejnë këtë formë dhune, por mund të themi se të rriturit nga mosha +18 mund të jenë të gjithë kryers të dhunës në familje. Pjesëmarrja e moshave të caktuara dallon edhe në kyqjen e tyre në kryerjen e krimeve të ndryshme. Kësisoj mosha e re merr pjesë më shumë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë si janë vjedhjet, vjedhjet me thyerje, plaçkitjet, trafiqet ilegale me narkotik etj., ndërsa të rriturit në krimet tjera duke filluar prej krimeve kundër jetës dhe trupit, dhunimet, krimi i organizuar etj.⁷⁵

⁷³ Dr.sc.Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë,2018, fq.114

⁷⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq.129

⁷⁵ Po aty, fq.130

3.3.3 Përgaditja shkollore

Në një mënyrë indirekte të dhuna në familje ndikon edhe fenomeni i shkollimit, për arsye se hasim në shumë pak përqindje të personave të shkolluar me arsim të lartë, dhe kjo gjë ndodh për shkak se buxheti i shtetit ndan shumë pak subvencione për njerëzit me vështirësi ekonomike e që nuk mund t'ia ofrojnë vetes një shkollim të denjë për të pasur një punë më të mirë dhe një jetë më pak vështirësi ekonomike.

Përgaditjet shkollore, arsimim luajn një rol të rëndësishëm për sa i përket parandalimit të kriminalitetit nëpërmjet edukimit. “Enriko Feri thekson se kriminaliteti zvogëlohet në shoqëri krahas rritjes së shkallës së arsimimit të popullsisë zvogëlohet injoranca, mosdija, zhduken veset e këqija etj. Përkundër tij qëndron autori Rafaelo Garafalo, i cili thekson se arsimimi i armatos me dijeni dhe i aftëson individët delikuent që më lehtë pa vështirësi të kryejnë sjellje të ndryshme kriminale. Sipas literaturës kriminologjike janë shpreh pikëpamjet që moti për çështjen e marrëdhënies ndërmjet arsimit si kriter aktivitetit kriminal duke u nisur kryesisht nga përgatitja shkollore dhe shkalla e arsimimit si kriter të personit që ka arsim e kulturë, është i edukuar se me anë të arsimimit të njerëzve luftohen shumë të këqija shoqërore.”⁷⁶

Personat e arsimuar, me vështirësi mund të bien në ndikime negative. Ata janë të paisur me dije dhe informata të shumta dhe e kanë më lehtë të marrin qëndrime dhe sjellje positive. Për këtë arsye është theksuar se, personat e arsimuar, gati gjithherë sillen në pajtim me normat ligjore dhe morale të një shoqërie.⁷⁷ Arsimimi zvogëlon injorancën, mosdijen, zhduk veset dhe shprehit e këqia, ndikon në braktisjen e adeteve dhe relikteve të vjetra. Arsimimi i përgadit njerëzit që të jenë të aftë tu kundërvihen provokimeve dhe nxitjeve të ndryshme të jetës së përditshme. Edhe sot në bisedat e përditshme theksohet se, personat e arsimuar më shpejt i kuptojnë rrjedhat dhe proceset e ndryshme ekonomiko-shoqërore dhe politike, se më lehtë i dallojnë dukuritë e ndryshme në shoqëri dhe më me shpejtësi marrin qëndrim lidhur me këto rrjedha. Prandaj personat e arsimuar më pak merren me veprime dhe sjellje kriminale sepse, si thuhet, kanë aftësi të gjykojnë për pasojat dhe dëmin që u sjellin veprimet eventuale kriminale.⁷⁸

⁷⁶ Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.260.


⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Po aty.

Nga ana tjetër, personat e pa arsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore, atyre u mungon aftësia për ti kuptuar dhe gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme, për çka ata nuk janë të aftë tu bëjnë rezistencë nxitjeve dhe sprovave të ndryshme të ambientit shoqëror. Shpeshherë në literaturën kriminologjike, për tu dëshmuar roli dhe rëndësia që ka arsimimi dhe dijenia përmendet një mendim i shkrimtarit të madh francez, Victor Ygos “Hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu”.⁷⁹

Duke u nisur nga përgjigjet e personave të anketuar në qytetin e Tetovës, në pyetjen: A mendoni se njerëzit e arsimuar janë më pak të pranishëm në dhunën familjare? Të anketurit janë përgjigjur:

Grafikoni 7.



Siç mund të vërejmë nga paraqitja grafike, rezulton se të anketuarit janë përgjigjur 60% nga ata se pajtohen që personat e arsimuar janë më pak të pranishëm në dhunën në familje, 34% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk pajtohen, ndërsa vetëm 6% e tyre janë përgjigjur se nuk kanë njohuri.


⁷⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.260.

3.4 Qëndrimet e popullsisë mbi raportin e dhunës në familje

Në përgjithësi, dhuna përcaktohet si diçka e padëshirueshme, e cila shkakton dëm dhe kjo mund të shfaqet në mënyra të ndryshme. Ndodh brenda kornizës shoqërore dhe manifestohet në sferat publike dhe private. Janë të njohura ekzistenca e ngjarjeve të dhunshme në shtëpi dhe brenda familjes.

Dhuna në familje në disa situata edhe nuk raportohet nga gratë për shkak të gjendjes së keqe ekonomike. Gjatë realizimit të anketave në qytetin e Tetovës, në pyetjen se: A mendoni se gjendja ekonomike luan një rol të madh në dhunën në familje? Të anketuarit janë përgjigjur:

Grafikoni 8.



Duke analizuar përgjigjet e të anketuarëve në pyetjen se a mendoni se gjendja ekonomike luan një rol të madh në dhunën në familje, shohim se shumica e të anketuarëve janë përgjigjur, 70% pajtohen plotësisht, 28% nga të anketuarit nuk pajtohen, dhe vetëm 2% nuk kanë njohuri.

Faktorët që lidhen më shumë me dhunën në familje dhe brenda familjes janë konsumi i alkoolit dhe problemet ekonomike, në një masë më të vogël, ekziston një nivel i ulët kulturor dhe arsimor, zakonet e njerëzve si dhe prania e sëmundjeve mendore.

Kur marrim parasysh zonën e vendbanimit, nuk ka ndryshime shumë të dukshme se ku mund të kryhet më së shumti dhuna në familje, përveç në qoftë se kemi të bëjmë me përdorimin e drogës dhe në një nivel më të ulët kulturor dhe arsimor, të cilit njerëzit që jetojnë në vende rurale nuk do

të kishin shumë mundësi ekonomike për përdorimin e tyre, për dallim nga njerëzit në zonat urbane.

Institucionet duhet të veprojnë në formë të sinkronizuar pas denoncimit të dhunës, sepse viktimat kanë nevojë për ndihmë në shumë aspekte, ndihmë psikike, mjekësore, juridike dhe financiare për pavarësimin e tyre.⁸⁰

⁸⁰ <https://www.evropaelire.org/a/kerkohet-mbrojtje-institucionale-pas-denoncimit-te-dhunes-ne-familje-/29619755.html>

KAPITULLI IV-të

4 PARANDALIMI DHE MASAT PËR MBROJTJE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

4.1 Roli institucional preventues

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe shoqatat ndërmarrin masa parandaluese për pengim dhe zvogëlim të dhunës në familje, në pajtim me kompetencat e përcaktuara me ligj.⁸¹ Masat parandaluese ndërmerren nëpërmjet:

- promovimit të vlerave shoqërore dhe kulturore të sjelljes, të cilat bazohen mbi barazinë e femrave dhe meshkujve,
- vendosjes së programeve për sjellje të padhunshme nga mosha më e hershme në institucionet parashkollore,
- vendosjes të programeve për sjellje të padhunshme dhe kuptim të barazisë gjinore në shkollat fillore,
- vendosjes së programeve për zhvillimin e aftësive për zgjidhje paqësore të konflikteve, kuptim dhe vlerësim të parimit për mundësi të barabarta ndërmjet femrave dhe meshkujve, në shkollat e mesme,
- vendosjes së programit për zhvillimin e aftësive për zgjidhje paqësore të konflikteve, respektim të dinjitetit dhe prestigjit të personalitetit, mosdiskrimin dhe barazi ndërmjet meshkujve dhe femrave në institucionet e arsimit të lartë,
- sigurimit të punës profesionale këshillëdhënëse dhe të këshillimores në këshillimore për martesë dhe familje, qendrat për punë sociale dhe institucionet tjera,
- realizimit të fushatave ose programeve për ngritjen e vetëdijes dhe kuptimit të publikut të përgjithshëm për identifikimin dhe pasojat nga dhuna në familje,

⁸¹ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Neni 17

- vendosjes së trajnimeve të vazhdueshme për persona profesionalë për kryerjen e punëve në kompetencë të tyre dhe dhunës në bazë gjinore dhe
- ngritjes së nivelit të përgjegjësisë së medie të shtypura dhe elektronike për njoftim objektiv për rastet e dhunës në familje, me ç'rast nuk theksohen rrethanat të cilat mund të shënojnë shkelje të të drejtave të njeriut, dinjitetit të personit dhe shmangie të çdo lloj të diskriminimit të meshkujve dhe femrave.⁸²

4.2 Roli policisë në parandalimin e dhunës në familje

Me anë të punëve policore arrihen qëllime të ndryshme të cilat mund ti ndajmë në dy grupe kryesore. Pra fjala është për punët kryerja e së cilave pengon dhe zbulon deliktet, pastaj punët të cilat kanë të bëjnë me aplikimin e dispozitave në mënyrë të drejtpërdrejt, nxjerrjen e akteve administrative, kryerjen e veprimeve administrative, ndërmarrjen e masave administrative dhe të mbikqyrjes administrative. “Fushëveprimi i punës së policisë, që në një masë të madhe bartë atributin e organit represiv si dhe të veprimit reaktiv, sot ajo gjithnjë e më tepër po ju kushton kujdes edhe modaliteteve dhe formave të tjera të reagimit ndaj sjelljeve paradelikente. Pra, trendet bashkëkohore në fushat relevante shkencore forenzike, organizative, penale dhe të tjera i kushtojnë vëmendje veprimit profilaktik të policisë në periudhën para kryerjes së drejtpërdrejtë të veprës penale (ante delictum).”⁸³

“Nëpunësi policor, gjithmonë kur ka paraqitje për dhunë në familje, e për shkak të mënjanimin të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën dhe integritetin fizik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, detyrohet të dalë në vendin e ngjarjes dhe të përpilojë raport policor menjëherë, e më së voni në afat prej 12 orë nga intervenimi në ngjarje. Nëpunësi policor në raste të dhunës në familje, gjatë ndërmarrjes së punëve policore dhe zbatimit të autorizimeve policore, masave operative - teknike dhe parandaluese të përcaktuara me Ligjin për polici, gjithmonë bën vlerësim të rrezikut mbi jetën dhe integritetin trupor të viktimës dhe të rrezikut nga përsëritja e dhunës, me

⁸² Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Neni 17

⁸³ <https://aab-edu.net/uploads/docs/librat/PARANDALIMI%20I%20KRIMINALITETIT-%20Elmedin%20MURATBEGOVIQ.pdf>

qëllim të mbrojtjes së viktimës, përmes menaxhimit përkatës me rrezikun.”⁸⁴ Gjithashtu nënpunësi policor detyrohet që viktimën ta marrë në mbrojtje shëndetsore menjëherë. Nënpunësi policor në afat prej 12 orësh detyrohet të paraqesë te gjykata kompetente propozim për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje – largimi i kryesit nga shtëpia dhe ndales për tu afruar te shtëpia, si dhe raportin policor të përpiluar nga vetë nënpunësi policor. Nënpunësi policor në afatin e cekur më lartë detyrohet që të njoftojë qendrën për punë sociale për ndërmarjen e masave të mbrojtjes së viktimës.

Me qëllim të parandalimit të aktiviteteve kriminale, policia ndërmer masa të shumta dhe të llojllojshme. Vëllimi dhe struktura e këtyre masave varet nga specifikat e rrethanave shoqërore në të cilat ndërmeren. Forma e organizatës shtetërore dhe shoqërore, vëllimi dhe struktura e kriminalitetit kushtet ekonomike sociale janë vetëm disa nga elementet të cilat përcaktojnë përmbajtjen e aktivitete policore në parandalimin e kriminalitetit.⁸⁵

Si masa më të zbatuara policore që kanë karakter preventiv mund të përmenden:

- Shërbimi patrullues(analizat kompjuterike);
- Mbikëqyrja dhe sigurimi i objekteve;
- Shërbimi paralajmërues;
- Sigurimi i tubimeve publike;
- Masat antidiversion;
- Evidencat dhe lejet;
- Verifikimi i identiteti;
- Kontrolli i komunikacionit publik;
- Përpunimi i të dhënave të hulumtimit analitik –statistikë;
- Informimi i qytetarëve dh puna në komunitet;
- Ndërmjetësimi jo formal në zgjidhjen e konflikteve;
- Kontrolli i sforcuar i të kthyerve;
- Bashkëpunimi brenda organizatave policore ndërkombëtare;⁸⁶

⁸⁴ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Neni 29

⁸⁵ <https://aab-edu.net/uploads/docs/librat/POLITIKAç20Eç20LUFTIMITç20TEç20KRIMINALITETIT-ç20M.ç20ABAZOVIOQ-ç20E.ç20MURATBEGOVIQ-ç20H.HALILOVIQ-M.BUDIMLIQ-E.ç20BEQIREVIOQ.pdf>

⁸⁶ Stojanoviq, Z.: „Politika e luftimit të kriminalitetit“, Novi Sad, 1991., fq. 80.

“Gjatë dhjetë viteve të fundit, me ndikimin e faktorëve të ndryshëm shoqëror, (një nga faktorët më të rëndësishëm sot paraqet frika në rritje nga krimi midis qytetarëve. Hulumtimet tregojnë se në bashkësitë bashkëkohore ky tip i frikës e ka tejkaluar madje edhe frikën nga lufta dhe disa kataklizmi më të vrazhda.) paraqiten disa qasje të reja në angazhimin e policisë në parandalimin dhe kontrollin e sjelljeve kundërligjore në përgjithësi. Këto qasje, për shkak të aktualitetit të vet, meritojnë një kujdes të madh në radhë të parë për shkak të përpjekjeve për ndryshimin e qëndrimeve tradicionale në fushën e punës policore. Pra, një nga karakteristikat më të rëndësishme të përbashkëta të orientimeve dhe të strategjive të përmendura paraqet insistimi në interaksionin e veprimit policor në bashkësinë lokale. Bashkësia lokale, si tërësi fundamentale administrative – gjeografike sot në bashkësitë moderne shtetërore paraqet një faktor të qenësishëm në dizajnimin e ambientit të vetë të sigurisë dhe të rrethinës në përgjithësi.”⁸⁷

Organizatat policore gjegjësisht organet e punëve sikurse shërbimet tjera të specializuara kanë për detyrë tu përshtaten ndryshimeve demokratike në shoqëri në pajtimi me obligimet kushtetuese dhe ligjor në planin e brendshëm si dhe aktiviteteve ndërkombëtare me çka do të përmbushnin rolin e tyre kriminal-politik.⁸⁸

Faktorët e rëndësishëm të cilët kanë të bëjnë me efikasitetin e punëve preventive të policisë janë:

- Ndhima qytetare;
- Aftësia kadrovike ;
- Përgatitja teknike;
- Shkalla e korrupsionit të brendshëm;
- Arsimimet dhe specializimet e vazhdueshme;
- Sistematizimi i njësive organizative;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Bashkëpunimi me sektorin privat të sigurisë (agjencitë e sigurimit).⁸⁹

⁸⁷ <https://aab-edu.net/uploads/docs/librat/PARANDALIMIç20Iç20KRIMINALITETIT-ç20Elmedinç20MURATBEGOVIO.pdf>

⁸⁸ Krivokapiq, V., FSHK, Sarajevë, 2006., fq . 255-260.

⁸⁹ Ignjatović, GJ., Kriminologija, J.P. „Fleta Zyrtare“, Beograd, 2005., fq. 344.

4.3 Roli entit për punë sociale në parandalimin e dhunës në familje

Dukuria e dhunës në familje, si dhe dukuria e kriminalitetit nuk mund të parandalohen dhe të luftohen me sukses në qoftë se nuk egziston një bashkpunim mes institucioneve dhe organeve relevante. Me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, nevojitet një bashkpunim i mirë ndërmjet organeve shtetërore të drejtësisë me organizatat e agjencive të ndryshme të cilat merren me problematikën e dhunës në familje si dhe mbrojtjes ndaj saj.

Këtu në rend të parë mendohet në bashkpunimin mes policisë, prokurorisë dhe gjykatave e organizatave dhe shoqatave joqeveritare për një varg çështjesh lidhur me ndihmën, mbështetjen e viktimave prej momentit të parë të viktimizimit e deri në fazën finale të realizimit të kompensimit dhe dëmshpërblimit.⁹⁰

“Qendra për punë sociale masat për mbrojtje i realizon përmes punës profesionale, këshillëdhënëse, të këshillimores dhe punës ekipore ndërdisiplinore. Qendra për punë sociale kryen vlerësim të nevojës për mbrojtjen e viktimës, sipas llojit, intensitetit, kontekstit të ndodhjes së dhunës, statusit shëndetësor dhe familjar të viktimës, moshës së saj dhe rrethanave tjera në procedurën për ndërmarrjen e masave të nevojshme për mbrojtje. Qendra për punë sociale, përpilon plan për punë individuale me shfrytëzues dhe konstatim dhe mendim të ekipit profesional.”⁹¹

Në rastet kur egziston rrezik për sigurinë e shëndetit dhe jetës së viktimës dhe familjarëve të saj, atëher nga ekipi profesional multisektorial do të përpilohet plan i sigurisë për jetë. Ky ekip përbëhet nga persona profesional, nga policia, nga qendra për punë sociale dhe nga institucionet shëndetësore nga rajoni në të cilin është kompetent qendra. ”Në punën e ekipit profesional multisektorial marrin pjesë përfaqësues të shoqatave, që punojnë në sferën e dhunës në familje, që mund të propozojnë dhe zbatojnë masa dhe aktivitete nga plani i sigurisë për ndihmë të viktimës. Në rast kur ekziston njohuri për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të fëmijës gjatë dhunës familjare, ekipi profesional multisektorial në planin e sigurisë për ndihmë të prindit do të parashohë edhe masa dhe aktivitete të cilat do të duhet të zbatohen për ndihmë të fëmijës. Ekipi profesional multisektorial formohet në qendrën për punë sociale kompetente sipas vendbanimit,

⁹⁰ Dr. Ragip Halili “Viktimologjia” – Prishtinë 2011, fq.163

⁹¹ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Neni 22

respektivisht vendqëndrimit të viktimës, për koordinim të aktiviteteve në sigurimin e ndihmës së viktimës në pajtim me nevojat e saj.”⁹² Qendra për punë sociale siguron që ndaj viktimës të realizohen të gjitha të drejtat nga mbrojtja sociale dhe shëndetsore të cilat janë në pajtim me ligjin.

“Me qëllim të parandalimit të viktimizimit është më se i nevojshëm bashkëpunimi ndërkombëtar në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me viktimat dhe të drejtat e tyre. Shtetet nënshkruese të konventave të OKB-së dhe konventave të OSBE-së janë edhe ashtu të obliguara t’i ofrojnë ndihma dhe informacione njëra tjetrës. Përfaqësitë dipolomatike dhe shërbimet konsullore duhet të ofrojnë ndihmë dhe informata për shtetasit e vet që janë bërë viktima ose kanë pësuar demtime të ndryshme.”⁹³

4.4 Legjislacioni dhe mbrojtja e dhunës në familje

Sipas ligjit për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, me nocionin e dhunës në familje nënkuptojme: “Me nocionin dhunë në familje nënkuptohet keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhuna tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit ose frikës, duke përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose ekonomi të përbashkët familjare, si dhe ndaj bashkëshortit të tanishëm apo të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryerësi e ndan ose e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën ose jo.”⁹⁴

4.4.1 Mbrojtja juridiko-penale nga dhuna në familje

“Sistemi penalo-juridik i Republikës së Maqedonisë së Veriut bën dallimin e veprave penale në kontekst të dhunës

⁹² “Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 23

⁹³ Dr. Ragip Halili “Viktimologjia” – Prishtinë 2011, fq.163

⁹⁴ “Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 3

në familje. Në kodin penal nuk parashihet inkriminim vetanak, i posaçëm i dhunës në familje. Përkundrazi, sjellja e dhunshme ndaj një anëtarit të familjes apo ndaj ndonjë personi në lidhje të afërt intime është e inkriminuar në më tepër vepra penale. Idea për një zgjidhje të tillë bazohet në seriozitetin e dëmit nga një sjellje e caktuar e dënueshme me ligj. Është miratuar qasja që dhuna në familje është po aq vepër e rëndë penale sa edhe veprat e rënda penale. Por, njëkohësisht definohet edhe si sjellje e dënueshme specifike, me atë që relacioni i afërsisë dhe intimitetit mes ushtruesit të dhunës dhe viktimës bëhet element kualifikues.

Ndalesa penalo-juridike për dhunë në familje përcakton edhe pozitën e shtetit ndaj familjes, gjegjësisht, pranohet parimi i zyrtarizimit të përndjekjes për vepra penale dhunë në familje. Fakti që për raste kur është bërë vepër dhunë në familje përndjekja ndërmirret si detyrë zyrtare dhe dënimi është më i rreptë në krahasim me formën bazë, sjell mbrojtje të posaçme për anëtarin e familjes nga ana e shtetit.”⁹⁵

Qendra për punë sociale i ndërmerr masat për mbrojtjen e viktimave, si vijojnë:

1. vendosje në qendër për persona – viktimë të dhunës në familje;
2. mbrojtje shëndetësore përkatëse;
3. intervenim përkatës psikik-social dhe trajtim;
4. trajtim psikik-social në këshillimore;
5. ndihmë të familjes për shkollimin e rregullt të fëmijës;
6. ndihmë juridike dhe përfaqësim dhe
7. përforsim ekonomik të viktimës përmes përfshirjes së saj aktive në tregun e punës.⁹⁶

Qendra për punë sociale detyrohet të fillojë procedurë menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orëve nga njoftimi i marrë, që të marrë masa për mbrojtjen e viktimës. Qendra për punë sociale, procedurën e fillon pas njohurisë së marrë se mbi personin është kryer dhunë në familje, me detyrë zyrtare, me kërkesë të viktimës, pas paraqitjes nga person fizik, person zyrtar, institucion ose shoqatë. Qendra për punë sociale, në rastet kur si viktimë paraqitet fëmijë ose person i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetveten ose person me aftësi pune të kufizuar ose të hequr, ndërmerr masa për mbrojtje, pa marrë parasysh nëse ekziston pëlqimi i prindit ose kujdestarit.⁹⁷

⁹⁵ http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/nasilstvo_strategija_alb.pdf

⁹⁶ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 18

⁹⁷ Po aty. Neni 19

“Qendra për punë sociale, kur si viktimë paraqitet fëmijë ose person i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetveten ose person të cilit i është kufizuar ose hequr aftësia për punë, përveç masave nga neni 18, ndërmerr edhe masa në pajtim me Ligjin për familje të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e raporteve të prindërve me fëmijët, mbikëqyrje mbi ushtrimin e të drejtës prindërore dhe kujdestarisë dhe në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve. Gjatë procedurave për besimin e fëmijës tek njëri prej prindërve, qendra për punë sociale e merr parasysh interesin e fëmijës – viktimë të dhunës në familje. Qendra për punë sociale përkohësisht mund t’i kufizojë ose ndalojë marrëdhëniet personale dhe kontaktet e drejtpërdrejta të fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton bashkë, në rast kur kjo është në interes të fëmijës-viktimë të dhunës në familje, por jo më gjatë se një vit.”⁹⁸ “Qendra për punë sociale masat për mbrojtje i realizon përmes punës profesionale, këshillëdhënëse, të këshillimores dhe punës ekipore ndërdisiplinore. Qendra për punë sociale kryen vlerësim të nevojës për mbrojtjen e viktimës, sipas llojit, intensitetit, kontekstit të ndodhjes së dhunës, statusit shëndetësor dhe familjar të viktimës, moshës së saj dhe rrethanave tjera në procedurën për ndërmarrjen e masave të nevojshme për mbrojtje.”⁹⁹

Nga ekipi profesional multisektorial përpilohet plan i ndihmës për siguri në rastet kur egzistojnë njohuri për rrezikimin e shëndetit dhe jetës së viktimës si dhe të familjarëve të saj. Ky ekip përbëhet nga persona profesionalë, nga policia, qendra për punë sociale dhe institucionet shëndetësore nga rajoni në të cilin është kompetent qendra.

“Në punën e ekipit profesional multisektorial marrin pjesë përfaqësues të shoqatave, që punojnë në sferën e dhunës në familje, që mund të propozojnë dhe zbatojnë masa dhe aktivitete nga plani i sigurisë për ndihmë të viktimës. Në rast kur ekziston njohuri për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të fëmijës gjatë dhunës familjare, ekipi profesional multisektorial në planin e sigurisë për ndihmë të prindit do të parashohë edhe masa dhe aktivitete të cilat do të duhet të zbatohen për ndihmë të fëmijës.”¹⁰⁰ Ekipi formohet në qendrën për punë sociale sipas vendqëndrimit të viktimës.

Vendosja e viktimës në qendrën për persona – viktimë të dhunës në familje kryhet kur ekziston njohuri për kërcënim real për jetën dhe shëndetin e viktimës dhe në mungesë të resurseve tjera për përkujdesje, që mund të zgjatë më së shumti tre muaj me mundësi për vazhdim edhe për tre

⁹⁸ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 20

⁹⁹ Po aty, Neni 22

¹⁰⁰ Po aty, Neni 23

muaj.¹⁰¹ Ndësa në raste të jashtëzakonshme, viktimat e dhunës në familje mund të qëndrojnë në qendrën për persona edhe për gjashtë muaj tjerë. Në qendër viktimave të dhunës në familje mund t’ju sigurohet intervenim psikik-social dhe trajtim. Kjo qendër formohet si institucion i veçantë për mbrojtjen sociale të viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale. Qendra siguron që viktimat të realizojë të gjitha të drejtat nga mbrojtja sociale dhe shëdetësore, të parapara me ligj.

“Për ndërprerje të dhunës, mënjanim të pasojave nga dhuna e kryer dhe ndërmarrje të masave efikase ndaj kryerësit të dhunës, për eliminim të shkaqeve për kryerje të dhunës së mëtutjeshme në familje, kryerësit të dhunës në familje mund t’i shqiptohen masat e përkohshme për mbrojtje, si vijojnë:

- 1) ndalim që të kërcënohet se do të kryejë dhunë në familje;
- 2) ndalim që të keqtrajtojë, shqetësojë, telefonojë, kontaktojë ose në mënyrë tjetër të komunikojë me anëtar të familjes, drejtpërdrejtë ose tërthorazi;
- 3) ndalim që të afrohet në distancë më të vogël se 100 metra deri te vendbanimi, shkolla, vendi i punës ose vendi i caktuar të cilin rregullisht e viziton anëtar tjetër i familjes;
- 4) largim nga shtëpia pa marrë parasysh pronësinë,
- 5) ndalim që të posedojë armë zjarri ose armë tjetër ose e njëjta t’i merret;
- 6) detyrimisht t’i kthejë sendet të cilat janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të përditshme të familjes;
- 7) mbajtje e detyrueshme ligjore e familjes;
- 8) detyrimisht të ndjekë këshillimore përkatëse;
- 9) mjekim i detyrueshëm i kryerësit, nëse keqpërdor alkool, drogë dhe substanca tjera psikotrope ose ka sëmundje psikike;
- 10) detyrimisht t’i kompensojë shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet tjera të shkaktuara nga dhuna në familje dhe
- 11) shqiptim të cilësdo mase tjetër të cilën gjykata do ta konsiderojë si të domosdoshme që të garantohet siguria dhe mirëqenia e anëtarëve tjerë të familjes.”¹⁰²

¹⁰¹ Po aty, Neni 24

¹⁰² Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 35

Masat e përkohshme për mbrojtje nga ligji mund të zgjasin më së paku tre muaj, kurse më së shumti një vit. Nëse dhuna në familje vazhdon edhe pas skadimit të periudhës në cilën është shqiptuar afati prej një viti, qendra për punë sociale ose viktimat mund të parashtrojnë kërkesë për vazhdim të masës. Ndërsa në qoftë se dhuna në familje do të ndodhë përsëri edhe pas kalimit të një viti, atëherë qendra për punë sociale ose viktimat parashtron propozim të ri në gjykatë. Në procedurat në të cilat gjykata vendos për masa të përkohshme për mbrojtje zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.¹⁰³

4.4.2 Ligji për parandalimin e dhunës në familje

Me këtë ligj rregullohet veprimi i përgjegjshëm dhe i domosdoshëm i institucioneve dhe shoqatave, koordinimi dhe bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë, për parandalim dhe pengim të dhunës në familje dhe sigurim të mbrojtjes së viktimave.¹⁰⁴

Qëllimet e këtij ligji janë ndërmarrja e masave të orientuara në mbrojtjen dhe parandalimin e viktimave të dhunës në familje, respektimi dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, integritetit personal, jetës, mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore, mbi interesat dhe nevojat e viktimës.

Me nocionin dhunë në familje nënkuptohet keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhuna tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit ose frikës, duke përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose ekonomi të përbashkët familjare, si dhe ndaj bashkëshortit të tanishëm apo të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryerësi e ndan ose e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën ose jo.¹⁰⁵

Viktimat kanë të drejtë për mbrojtje, ndihmë dhe përkrahje nga dhuna në familje. Viktima ka plotësisht të drejtë që të informohet nga personat zyrtar për të drejtat e saj, procedurat për

¹⁰³ Po aty, Neni 42

¹⁰⁴ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 1

¹⁰⁵ Po aty, Neni 3

realizimin e këtyre të drejtave, masat për mbrojtje dhe të informohet për shërbimet që janë arritur me anë të mbrojtjes dhe ndihmës. Viktimat kanë të drejtë që të zgjedhin personin i cili do ti shoqërojë në procedura. Si shoqërues mund të jetë çdo person i cili ka arritur moshën madhore, por jo ai i cili ka qenë kryerës i dhunës në familje në po të njejtën procedurë.

“Fëmija është viktimë kur pëson dhunë të drejtpërdrejtë, kur është i pranishëm në marrëdhënie të dhunshme ndërmjet anëtarëve të familjes së tij ose kur jeton në mjedis në të cilin ka marrëdhënie të dhunshme. Ndaj fëmijës kryerës të dhunës në familje nuk aplikohen masat e përkohshme për mbrojtje nga ky ligj, kurse aplikohen dispozitat e Ligjit për drejtësi të fëmijëve dhe dispozitat e Ligjit për familje të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënieve të prindërve dhe fëmijëve, mbikëqyrjen mbi realizimin e të drejtës prindërore dhe kujdestarisë.”¹⁰⁶

Qendra për punë sociale, për mbrojtjen e viktimës duhet të marrë masa dhe të fillojë procedurën menjëherë, e më se voni 24 orë prej nga njoftimi i marrë. Procedura duhet të fillojë pas njohurive të marra mbi personin që është kryer dhuna në familje.

“Në rastet kur ekziston njohuri për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të viktimës dhe anëtarëve të familjes, përpilohet plan i sigurisë për ndihmë, nga ekipi profesional multisektorial.

Ekipi profesional multisektorial, përbëhet nga persona profesionalë, nga qendra për punë sociale, policia dhe institucioni shëndetësor nga rajoni për të cilin është kompetent qendra.

Në punën e ekipit profesional multisektorial marrin pjesë përfaqësues të shoqatave, që punojnë në sferën e dhunës në familje, që mund të propozojnë dhe zbatojnë masa dhe aktivitete nga plani i sigurisë për ndihmë të viktimës.

Në rast kur ekziston njohuri për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të fëmijës gjatë dhunës familjare, ekipi profesional multisektorial në planin e sigurisë për ndihmë të prindit do të parashohë edhe masa dhe aktivitete të cilat do të duhet të zbatohen për ndihmë të fëmijës.”¹⁰⁷

Që të realizojnë viktimat të drejtë nga mbrojtja sociale dhe shëndetsore, e siguron qendra për punë sociale, kuptohet në pajtim me ligjin. Ndërsa ndihma juridike sigurohet në qendrën për punë sociale nga personat profesionalë.

¹⁰⁶ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”, Neni 10

¹⁰⁷ Po aty, Neni 23

Në procedurat e dhunës në familje për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje, vendos gjykatës individ. Në keto procedura është i përjashtuar publiku në seancën gjyqësore.

STATISTIKA

Tabela 1. Në vijim përmes tabelës do të paraqesim statistikën e të gjitha rastet e raportuara të veprave penale kundër martesës, familjes dhe rinisë, në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën kohore 2013-2018.¹⁰⁸

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Veprat penale kundër martesës, familjes dhe rinis	422	421	470	422	353	434

Në tabelë, sikurse edhe shihet, se në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgjatë periudhës kohore 2013-2018, rastet e raportuara të veprave penale kundër martesës, familjes dhe rinisë gjithsej janë: 2522 raste.

Në vitin 2013: shohim se krime kundër martesës, familjes dhe rinisë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë raportuar 422 raste.

Në vitin 2014: shohim se krime kundër martesës, familjes dhe rinisë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë raportuar 421 raste.

Në vitin 2015: shohim se krime kundër martesës, familjes dhe rinisë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë raportuar 470 raste.

Në vitin 2016: shohim se krime kundër martesës, familjes dhe rinisë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë raportuar 422 raste.

Në vitin 2017: shohim se krime kundër martesës, familjes dhe rinisë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë raportuar 353 raste.

¹⁰⁸ <http://www.stat.gov.mk>

Në vitin 2018: shohim se krime kundër martesës, familjes dhe rinisë në të gjithë teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë raportuar 434 raste.

Nga analizimi i tabelës më lartë, mund të kuptojmë se, në Republikën e Maqedonisë së Veriut për çdo vit janë raportuar një numër i madh i krimeve kundër martesës, familjes dhe rinisë. Numër më të ulët të raportimeve kemi në vitin 2017 (353 raste) ku vërehet një ulje, ndërsa ritje të numrit të raportuar kemi në vitin 2015 ku gjithsej janë 470 raste.

Tabela 2. Në vijim përmes tabelës do të paraqesim të dhënat statistikore të marra në Gjykatën Themelore të Tetovës,¹⁰⁹ për numrin e rasteve të pranura dhe të gjykuara në këtë gjykatë, për dhunën në familje.

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i rasteve të dhunës në familje	1	Nuk ka të dhëna	8	4	13	4

Sikurse mund të shohim te tabela, në Gjykatën Themelore të Tetovës, gjatë periudhës kohore 2013-2018, gjithsej ka pasur 30 raste.

Në vitin 2013: shohim se ka pasur vetëm 1 rast të gjykuar në Gjykatën Themelore të Tetovës, për dhunë në familje.

Në vitin 2014: nuk ka të dhëna për sa i përket dhunës në familje në Gjykatën Themelore të Tetovës.

Në vitin 2015: shohim se ka pasur 8 raste të gjykuara në Gjykatën Themelore të Tetovës, për dhunë në familje.

Në vitin 2016: shohim se ka pasur 4 raste të gjykuara në Gjykatën Themelore të Tetovës, për dhunë në familje.

¹⁰⁹ Të dhënat të marra nga Gjykata Themelore në Tetovë.

Në vitin 2017: shohim se ka pasur 13 raste të gjykuara në Gjykatën Themelore të Tetovës, për dhunë në familje.

Në vitin 2018: shohim se ka pasur 4 raste të gjykuara në Gjykatën Themelore të Tetovës, për dhunë në familje.

Duke analizuar tabelën më lartë, kuptojmë se në vitin 2017 janë kryer ose të themi ndryshe se në Gjykatën Themelore të Tetovës janë gjykuar më shumë raste të dhunës në familje, ku bëhet fjalë për një numër të 13 rasteve. Vitet 2016 dhe 2018 janë të njejta për nga gjykimi i rasteve edhe atë me nga 4 raste, viti 2015 ka pasur dyfishim e rasteve për dallim nga vitet 2016 dhe 2018 me një numër të 8 rasteve. Ndërsa për nga numri më i ulët i rasteve të gjykuara në Gjykatën Themelore të Tetovës për periudhën kohore 2013-2018, më pak raste ka pasur në vitin 2013, edhe atë vetëm 1 rast.

Në vazhdim do të përshkruajmë njërin nga rastet e marra në Gjykatën Themelore të Tetovës:

Gjykata Themelore në Tetovë

Vendim

Është pranuar propozimi i të pandehurës D.J dhe vajzës e saj T.J, të dyja nga fsh.Rahotince.

I shqiptohet dënim i përkohshëm të akuzuarit A.J nga fsh.Zhillçe-Tetovë.

I ndalohet të akuzuarit A.J nga fsh.Zhillçe, që të vazhdojë me kërcënime e tij për dhunë në familje.

I ndalohet të akuzuarit A.J nga fsh.Zhillçe, që ti shqetësoj, ti telefonojë, të komunikojë në çfarë do lloj mënyre me ta, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte.

I urdhërohet të akuzuarit A.J nga fsh.Zhillçe, që të vizitojë spitalin psikologjik 1 herë në javë, në Qendrën për shëndetin mental në Tetovë, për shkak të gjendjes së tij psikologjike, në kohëzgjatje deri në 6 muaj.

Arsyetim

E pandehura D.J nga fsh.Raotince ka paraqitur rastin e dhunës, midis saj dhe ish bashkëshortit të saj A.J, në ç'rast në këtë mes ishte e përfshirë edhe vajza e saj T.J.

D.J deklaroi se ishte e dhunuar nga ana e ish bashkëshortit të saj, dhe se ai çdo ditë e kërcënonte atë dhe vajzën e saj, i gjithë rasti ndikohet nga ana e kërcënimeve që i bënte A.J, ai i kërcënonte se do ti vriste ata ngado që do ti shihte. Ish bashkëshortja D.J kërkonte nga Gjykata Themelore në Tetovë, që ish bashkëshorti i saj të shtrohej në spitalin psikologjik-mental në Tetovë.

Ajo gjithashtu akuzonte ish bashkëshortin, se ai i dërgonte mesazhe kërcënuese në telefon asaj. Ndërsa i akuzuari, i hedh poshtë këto ankesa, duke u shprehur se ata tentojnë që t'ia prishin imazhin dhe karakterin e tij.

Mirpo Gjykata mundësoi vërtetimin e këtyre mesazheve dhe vërtetoi se të gjitha kërcënimet ishin të sakta, dhe se po të njejtat ishin të dërguara nga ana e A.J.

Të miturit, fëmijët e tyre, T.J dhe S.J refuzojnë të takojnë babain e tyre, për shkak të sjelljeve të tij ndaj tyre dhe për shkak të dukjes së tij.

I gjithë rasti përfundon me vendimin e Gjykatës me 3 muaj burg për A.J si dhe vizita në spitalin psikiatrik në Tetovë.

Kunër këtij vendimi, mund të parashtrohet ankesë në afat kohor prej 3ditësh nga dita e marrjes së vendimit, në Gjykatën e Apelit në Gostivar.

PËRFUNDIMI

Fatkeqësisht, dhuna në familje është një fenomen të cilin ne e dëgjojmë çdo ditë dhe është njëri ndër fenomenet më të përhapura në mbarë botën. Edhe pse dhuna në familje është e analizuar dhe e trajtuar mjaft mirë, mund të vërejmë se edhe në ditët e sodit nuk do të jetë e mjaftueshme studimi dhe trajtimi i ndryshëm kërkimorë-hulumtues i këtyre veprimeve kriminale, me anë të së cilave atakohet jeta dhe trupi i njeriut si dhe rrezikohet siguria fizike dhe shëndeti i njeriut.

Përgjatë vështimit dhe analizimit të anktës së bërë në qytetin e Tetovës, në periudhën kohore; shtator-tetor, ka rezultuar se: një numër më i madh i të anketurëve ishin të vetëdijshëm për fenomenin e dhunës në familje dhe format e dhunës, ndërsa për informatat se nga janë të informuar për egzistimin e kësaj dhune, shumica, 50% e të anketarëve janë përgjigjur se janë të informuar më shumë nga mediat. Sot duhet që të gjithë njerëzit të jenë të vetëdijshëm, se dhuna në familje nuk mund tju ndodh vetëm të tjerëve por mund të ndodhë edhe brenda familjes sonë.

Duke pasur parasysh se dhuna në familje dënohet, të gjithë viktimat mund që ta raportojnë atë. Mirpo përgjatë anketimit, në pyetjen se a e shprehin lirshëm dhunën që kanë brenda në familje njerëzit?, kemi 70% nga ata të cilët pajtohen plotësisht se dhuna brenda familjes në shoqërinë tonë nuk mund të shprehet edhe aq lirshëm. Informimi i popullsisë mbi këtë lloj dhune është i domosdoshëm, informacioni mund të ndihmojë në formimin pozitiv të qëndrimeve të shoqërisë ndaj njerëzve, si fusha themelore dhe më të vjetra të informimit mund të cekim: mediat dhe shkollat. Ndërsa për sa i përket raportimit të dhunës në familje, në përgjigjen e pyetjes se a duhet që të raportohet dhuna në familje?, të anketuarit janë përgjigjur, 86% prej tyre me Po, ndërsa 14% me Jo. Sigurisht që qëllimi kryesor është që të dhunuarit të ndërgjegjesohen që ta raportojnë dhunën dhe të kërkojnë mbrojtje nga shteti, çdo njeri duhet të ndjehet i sigurt në ambientet në të cilat jetojnë, kjo është një e drejt themelore e secilit prej individëve. Në pyetjen se ku mendoni se është më shumë e përhapur dhuna në familje, rezultojmë se 60% janë përgjigjur në qytet, 30% në fshat dhe 10% në të dyja rastet.

Për sa i përket gjinisë së kryerjes së dhunës në familje, duke analizuar përgjigjet e të anketuarëve, shohim se shumica e të anketuarëve ku 75% e tyre, janë përgjigjur se burri është ai i cili ushtron dhunën në familje më së shumti, 15% janë përgjigjur nga grua, 5% nga të moshuarit dhe 5% tjetër. Kjo na bën të kuptojmë se edhe në vendin tone ashtu si dhe në

shumicën e vendeve të botës, është gjinia mashkullore ajo që ushtron më shumë dhunë në bashkësin familjare. Në shoqërinë tonë ka shumë më pak raste ku gratë ushtrojnë dhunë ndaj bashkëshortëve të tyre. E vetmja formë dhune e cila mund të ushtrohet ndaj burrave nga grate, mund të jetë ajo psikologjike.

Gjithashtu vërejmë që përgaditja shkollore luan një rol të rëndësishëm në paraqitjen e dhunës në familje, Arsimiti zvogëlon injorancën, mosdijen, zhduk veset dhe shprehit e këqia. Të anketurit janë përgjigjur në pyetjen, mendoni se njerëzit e arsimuar janë më pak të pranishëm në dhunën familjare?, 60% nga ata se pajtohen që personat e arsimuar janë më pak të pranishëm në dhunën në familje, 34% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk pajtohen, ndërsa vetëm 6% e tyre janë përgjigjur se nuk kanë njohuri.

Ndërsa përgjatë vështrimit dhe analizimit të statistikave të të gjithë rasteve raportuara të veprave penale kundër martesës, familjes dhe rinisë , në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën kohore 2013-2018, ka rezultuar se gjithsej në Republikës së Maqedonisë së Veriut kemi 2522 raste të raportuara, nga gjithsej rastet në vitin 2013 kemi 422 raste, në vitin 2014 kemi 421 raste, në vitin 2015 kemi 470 raste, në vitin 2016 kemi 422 raste, në vitin 2017 kemi 353 raste, dhe në fund në vitin 2018 kemi 434 raste. Si rrjedhojë mund të konkludojmë se numri më i madh i rasteve të raportuara të veprave penale kundër martesës, familjes dhe rinisë në e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën kohore 2013-2018, janë në vitin 2015 ku gjithsej janë 470 raste, ndërsa ulje të rasteve të cilat janë të paraqitura janë në vitin 2017 me 353 raste.

Nga hulumtimi i bërë , nga analiza e të dhënave statistikore të marra në Gjykatën Themelore të Tetovës, për numrin e rasteve të pranuara dhe të gjykuara në këtë gjykatë, për dhunën në familje, gjatë periudhës kohore 2013-2018 gjithsej kishim 30 raste, rezultojmë se; në vitin 2013 kishim vetëm 1 rast, për vitin 2014 nuk ka të dhëna, në vitin 2015 kishim 8 raste, në vitin 2016 kishte 8 raste, në vitin 2017 kishim 13 raste dhe në vitin 2018 kishim 4 raste. Kështu në vitin 2017 në Gjykatën Themelore të Tetovës janë gjykuar më shumë raste të dhunës në familje, ku bëhet fjalë për një numër të 13 rasteve. Vitet 2016 dhe 2018 janë të njëjta për nga gjykimi i rasteve edhe atë me nga 4 raste. Ndërsa për nga numri më i ulët i rasteve të gjykuara në Gjykatën Themelore të Tetovës për periudhën kohore 2013-2018, më pak raste ka pasur në vitin 2013, edhe atë vetëm 1 rast.

Duke qenë një nga fenomenet më komplekse, parandalimi për ta kuruar këtë fenomen është sa personal ashtu edhe i përgjithshëm. Dhuna në familje sidomos tek gratë dhe fëmijët, është shumë e rëndësishme për tu vërejtur, njerëzit duhet të bëhen më të vetëdijshëm se si ta shmangin këtë dhunë dhe cilat masa duhet të merren në rast se kjo ndodh brenda familjeve të tyre.

Për t'i dhënë fund kësaj situate është e rëndësishme që të kryhet një punë e përbashkët e tërë shoqërisë, duke realizuar një veprim kolektiv dhe duke sulmuar problemin direkt nga rrënjët. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, egzistojnë aktualisht 4 qendra rajonale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, të cilat gjenden në: Shkup, Koçan, Sveti Nikoll dhe Manastir. Gjithashtu në Kumanovë, Shkup dhe Tetovë, brenda ambienteve të kujdesit shëndetsorë janë hapur qendra për viktimat e dhunës seksuale.

LITERATURA

LIBRA:

- B.Netkova&tjere , Human Right and domestic violence,Tetovë, 2007
- Vllado Kambovski, Kazнено pravo-poseban del, Skopje, 2012
- Zejneli Ismail , E drejta penale pjesa e posame, Tetovë,2007
- Ismail Zejneli , Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë, 2018
- A.Ali&H.Gashi , E drejta familjare, Prishtinë, 2007
- A.Mandro , Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martësore, Tiranë, 2014
- Begeja, Skender, Kriminalistika, Tiranë, 1997.
- Dragoti, Edmond, 2012"Psikologjia sociale", Ribotim, Tiranë,.
- H.Podvorica , E drejta familjare, Prishtinë, 2006
- Ismet Salihu , E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 1995
- Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009.
- M.H.Vardarski , Semejno pravo, Skopje, 1980
- Ragip Halili , Kriminologjia, Prishtinë, 2016
- Ragip Halili , Viktimologjia, Prishtinë, 2011
- Stojanovič, Z., „Politika e luftimit të kriminalitetit”, Novi Sad, 1991.
- Vesel Latifi , Kriminalistika, Prishtinë,2014
- Vesel Latifi , Politika e parandalimit të krimit, Prishtinë, 2013

BURIME TJERA:

- Kodi penal i R.Maqedonisë
- Ligji i procedures penale i R.Maqedonisë
- Ligji për parandalim, ndalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje
- Ligji mbi Familjen i R.Maqedonisë
- Deklarata Universale për të drejtat e njeriut
- Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa mbi të drejtat e fëmijëve, Tiranë
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
- Konventa për të drejtat e femijëve

- Deklarata universale e të drejtave të njeriut, e aprovuar nga Ansambleja e Përgjithëshme e OKB'së, dhjetorë 1948
- Deklarata për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër, 1798.
- Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Protokoll i përbashkët në raste të dhunës në familje, Republika e Maqedonisë.
- Ligji për Policinë i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.114/06/148/08, mars 2015.

BURIME NGA INTERNETI:

- <https://www.krizencentar.org.mk/files/brosurakrizencentaralbanska.pdf>
- https://www.cji.edu/site/assets/files/1921/domestic_abuse_report.pdf
- <https://www.helpguide.org/articles/abuse/domestic-violence-and-abuse.htm/>
- https://www.unicef.org/kosovoprogramme/Final_Gender_based_SHQIP_int.pdf
- <https://www.slideshare.net/erginushi/stop-dhuna>
- <https://www.lifeline.org.au/get-help/topics/domestic-family-violence>
- <http://www.forodeseguridad.com/artic/miscel/6089.htm>
- <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1334>
- https://books.google.mk/books?hl=en&lr=&id=v7n5zP3uKn8C&oi=fnd&pg=PP11&dq=domestic+violence+against+women+essay&ots=DIJDfumnP-&sig=IYrM9HPO24OZo40tZhQWuBWq6ho&redir_esc=y#v=onepage&q&f=false
- <https://sbunker.net/me-tager/89254/per-dhunen-ndaj-burrave/>
- <https://www.helpguide.org/articles/abuse/help-for-men-who-are-being-abused.htm>
- <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>
- https://www.coe.int/t/pace/campaign/stopviolence/Source/handbook_al.pdf
- http://scielo.isciii.es/scielo.php?script=sci_arttext&pid=S1132-05592006000300002
- <http://www.copib.es/pdf/imsero-malostratos-01.pdf>

- http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/semajno_nasilstvo_anketa.
- <https://mvr.gov.mk/vest/4980>
- http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/semajno_nasilstvo_anketa.pdf
- <https://vdocuments.site/parandalimi-i-kriminalitetit-elmedin-muratbegoviq-1pdf.html>

SHTOJCA

Instrumenti hulumtues

Pyetsori në lidhje me dhunën në familje

Vendi: Tetovë,

Periudha kohore: shtator-tetor,

Viti: 2019

Ky pyetësor është pjesë përbërëse e punimit shkencor “ Dhuna në familje, shkaqet e paraqitjes në familjet shqiptare në rajonin e Pollogut, periudha kohore 2013-2018”. Qëllimi i këtij hulumtimi është grumbullimi i të dhënave për përpilimin e punimit shkencor dhe nuk do të përdoret për qëllime të tjera.

Ju lutem në pyetjet në vazhdim të përgjigjeni sinqerisht.....

1. Vendbanimi

- a) Qytet
- b) Fshat

2. Gjinia

- a) Femër
- b) Mashkull

3. Përkatësia etnike

- a) Maqedonas
- b) Shqipëtar
- c) Turk
- d) Tjerë

4. Mosha

- a) 18-25
- b) 26-33
- c) 34-41
- d) 42+

5. Përkatësia fetare

- a) Musliman/e
- b) Katolik/e
- c) Ortodoks
- d) Tjerë

6. Profesioni

- a) Nxënës/Student
- b) I/ e punësuar
- c) Tjetër

7. Arsimimi

- a) Arsim fillor
- b) Arsim i mesëm
- c) Arsim i lartë

8. Lloji i shtëpisë aktuale

- a) Shtëpi
- b) Banesë
- c) Tjetër

9. A mendoni se dhuna në familje është më e përhapur në fshat apo në qytet

- a) Fshat
- b) Qytet
- c) Ne të dyja rastet

10. A jeni të vetëdijshëm se jetoni në një zonë ku është e pranishme dhuna në familje

- a) Po
- b) Jo

11. Nëse po, atëher prej ku i keni informatat

- a) Kam qenë dëshmitar/e i një dhunë në familje
- b) Nga antarët më të moshuar të familjes sime
- c) Nga mediat
- d) Tjetër

12. A mendoni se gjendja ekonomike luan një rol të madh në dhunën në familje

- a) Pajtohem plotësisht
- b) Nuk pajtohem
- c) Nuk kam njohuri

13. Sa % ndikon tradita në dhunën në familje

- a) 30%
- b) 50%
- c) 100%
- d) Nuk ndikon

14. Nga cili antarë mendoni se shkaktohet më së shumti dhuna në familje

- a) Burri
- b) Gruaja
- c) Të moshuarit
- d) Tjetër

15. A mendoni se njerëzit e arsimuar janë më pak të pranishëm në dhunën familjare

- a) Pajtohem
- b) Nuk pajtohem
- c) Nuk kam njohuri

16. Kur është hera e fundi që keni dëgjuar apo keni qenë vetë dëshmitar i dhunës në familje

- a) Ne vitin e fundit
- b) Ne 3 vitet e fundit
- c) Asnjëherë

17. A mendoni se njerëzit nuk e shprehin lirshëm dhunën që kanë brenda familjes së tyre

- a) Pajtohem
- b) Nuk pajtohem
- c) Nuk kam njohuri

18. A mendoni se duhet të raportohet dhuna në familje?

- a) Po
- b) Jo

19. A është e pranishme dhuna në familjen tuaj

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk kam njohuri

20. Kur mendoni se ka qenë më e pranishme dhuna në familje

- a) Sot
- b) Para 20 viteve
- c) Para 50 viteve
- d) Nuk kam njohuri

21. A mendoni se ka mjaftueshëm institucione për mbrojtjen e të dhunuarve

- a) Pajtohem plotësisht
- b) Nuk pajtohem
- c) Nuk kam njohuri